

VLERËSIMI I INDEKSIT TË INTEGRITETIT PËR KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË



RAPORT VLERËSIMI

VLERËSIMI I INDEKSIT TË INTEGRITETIT PËR KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË

RAPORT VLERËSIMI



VLERËSIMI I INDEKSIT TË INTEGRITETIT PËR
KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË
RAPORT VLERËSIMI

Autoret:

Bojana Hajdini
Rozarta Dodaj

Redaktor letrar:

Durim Tabaku

Dizajn dhe layout:

Eduart Cani

© 2024 nga Instituti për Demokraci dhe
Ndërmjetësim. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)
Adresa: Rr. Shenasi Dishnica, Nd.35, H.1
1017 Tirana, Albania
E-mail: info@idmalbania.org
www.idmalbania.org



Institute
for Democracy
and Mediation



Suedi
Sverige

Ky dokument u hartua në kuadër të Projektit "Forcimi i integritetit për përmirësimin e shërbimeve publike" zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) me mbështetjen financiare të Ambasadës Suedeze në Tiranë. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Ambasadës Suedeze në Tiranë.

TABLE OF CONTENTS

HYRJE	5
1. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL	12
2. KONTROLLI I ZBATIMIT NË PRAKTIKË	13
3. REKOMANDIME PËR LLOGARIDHËNIEN	14
II. TRANSPARENCA PROAKTIVE	16
1. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL	23
2. KONTROLLI I ZBATIMIT NË PRAKTIKË	24
3. REKOMANDIME PËR TRANSPARENCËN PROAKTIVE	25
III. QASJA STRATEGJIKE	26
1. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL	31
2. KONTROLLI I ZBATIMIT NË PRAKTIKË	31
3. REKOMANDIME PËR QASJEN STRATEGJIKE	33
IV. STANDARDET ETIKE	34
1. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL	39
2. KONTROLLI I ZBATIMIT NË PRAKTIKË	39
3. REKOMANDIME PËR STANDARDET ETIKE	41
V. MERITOKRACIA	42
1. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL	46
2. KONTROLLI I ZBATIMIT NË PRAKTIKË	46
3. REKOMANDIME PËR MERITOKRACINË	47

SHKURTIME

ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
IDM	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
ILD	Inspektorati i Lartë i Drejtësisë
KLJG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KSHC	Komisionin e Shërbimit Civil
PBA	Plani Buxhetor Afatmesëm
PI	Plani i integritetit
PSV	Procedurat Standarde të Veprimit
TND	Trupë e nivelit drejtues

HYRJE

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) është një ndër institucionet kryesore të krijuara në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë në Shqipëri. Ky këshill u krijua me Ligjin Nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, dhe u ngrit më 19 dhjetor të vitit 2018. Këshilli ka kompetenca të rëndësishme në qeverisjen dhe administrimin e sistemit të prokurorisë, përfshirë këtu propozimin në Kuvend të kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm; emërimin e prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; emërimin, ngritjen në detyrë dhe vlerësimin e prokurorëve të të gjithë niveleve; vendosjen e masave disiplinore ndaj prokurorëve, etj. KLP ka për detyrë të garantojë pavarësinë, përgjegjshmërinë, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Shqipëri.

Referuar këtyre kompetencave të rëndësishme në administrimin e sistemit të prokurorisë, është e një rëndësie parësore që Këshilli të zbatojë ligjin me përpikëri dhe të zbatojë standarde të larta përgjegjshmërie, etike dhe integriteti, me qëllim rritjen e besimit të publikut te ky institucion dhe tek vetë sistemi i prokurorisë. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan administrata e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e cila është përgjegjëse për mbarëvajtjen e përditshme të punës së Këshillit. Në kryerjen e detyrave të saj, ajo duhet të reflektojë standarde të larta profesionalizmi, etike dhe integriteti. Në funksion të këtij qëllimi, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka miratuar dhe Planin e Integritetit të Administratës si një udhërrëfyes që do ta orientojë administratën në zbatimin e standardeve më të larta të integritetit.

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), me mbështetjen e Qeverisë së Mbretërisë së Suedisë, ka hartuar metodologjinë e vlerësimit të integritetit institucional si një mekanizëm që mund të përdoret nga kushdo i interesuar, për të monitoruar zbatimin e planeve të integritetit të institucioneve publike dhe ndikimin që kanë pasur masat e përcaktuara në to në forcimin e integritetit institucional.

Kjo metodologji vlerëson kuadrin institucional për promovimin e integritetit dhe luftën kundër korrupsionit, kapacitetet institucionale për përmbushjen e objektivave të integritetit të vendosura nga institucioni nëpërmjet planeve të integritetit; transparencën dhe llogaridhënien e institucionit ndaj përfituesve të shërbimeve; si dhe nëse institucioni e realizon veprimtarinë e tij në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Bazuar në këtë metodologji, më poshtë gjendet vlerësimi i integritetit institucional për Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Për realizimin e këtij vlerësimi është përdorur metoda cilësore dhe sasimore. Mbi bazën e hulumtimit të informacioneve dhe të dhënave (*desk research*) të kryera në faqen zyrtare të KLP, marrjes së të dhënave zyrtare prej vetë strukturave përgjegjëse të institucionit dhe kryqëzimit të informacionit, janë matur/vlerësuar treguesit e metodologjisë së vlerësimit të integritetit, duke dhënë shpjegimin përkatës për secilin prej tyre.

Sipas metodologjisë janë përcaktuar pesë fusha¹ të vlerësimit të integritetit të institucionit, të cilat vlerësohen sipas dy kritereve kryesore, konkretisht *kontrolli ligjor dhe institucional dhe kontrolli i zbatimit në praktikë*. Çdo fushë vlerësohet me 20 pikë secila, e ndarë në mënyrë të barabartë mes dy kritereve kryesore, ku secili kriter ka 10 pikë secili. Bazuar në të dhënat e përftuara sipas metodologjisë së përshkruar më lart, Këshilli i Lartë i Prokurorisë është pikëzuar si më poshtë vijon, sipas fushave përkatëse:

1 Llogaridhënia, transparenca, qasja strategjike, standardet e integritetit dhe meritokracia e burimeve njerëzore.

LLOGARIDHËNIA: 19 PIKË

kontrolli ligjor dhe institucional – 10 pikë nga 10 pikë në total

kontrolli i zbatimit në praktikë – 9 pikë nga 10 pikë në total

TRANSPARENCA PROAKTIVE: 11 PIKË

kontrolli ligjor dhe institucional – 6 pikë nga 10 pikë në total

kontrolli i zbatimit në praktikë – 5 pikë nga 10 pikë në total

QASJA STRATEGJIKE: 17 PIKË

kontrolli ligjor dhe institucional – 9 pikë nga 10 pikë në total

kontrolli i zbatimit në praktikë – 8 pikë nga 10 pikë në total

STANDARDET ETIKE: 7.5 PIKË

kontrolli ligjor dhe institucional – 5.5 pikë nga 10 pikë në total

kontrolli i zbatimit në praktikë – 2 pikë nga 10 pikë në total

MERITOKRACIA: 13 PIKË

kontrolli ligjor dhe institucional – 7 pikë nga 10 pikë në total

kontrolli i zbatimit në praktikë – 6 pikë nga 10 pikë në total

Në bazë të pikëzimit për çdo fushë, lidhur me **kontrollin ligjor dhe institucional**, KLP vlerësohet me **37.5 pikë**, duke demonstruar një nivel të lartë të zhvillimit të integritetit institucional. Institucioni, pavarësisht se është relativisht i ri, ka përgatitur dhe miratuar akte ligjore të brendshme, rregullore, plane dhe udhëzime, të cilat sanksionojnë veprimtarinë institucionale të KLP-së në përgjithësi dhe të administratës së KLP-së në veçanti. Pjesa më e madhe e këtyre akteve të brendshme janë publike dhe çdo punonjës është i njohur dhe i mirë informuar për mënyrën e zbatimit të tyre.

Lidhur me kriterin e dytë, atë të **kontrollit të zbatimit në praktikë**, KLP vlerësohet me **30 pikë**, duke shfaqur një nivel të ndërmjetëm të zhvillimit të integritetit institucional. Aktet, rregulloret, planet e veprimit, udhëzimet, etj., kanë një nivel zbatueshmërie relativisht të mirë, por që ka nevojë për përmirësime të mëtejshme, në mënyrë që të përmbushen plotësisht funksionet e këtyre akteve të brendshme të miratuara për një organizim dhe funksionim normal të institucionit. Niveli i ndërmjetëm i zhvillimit të integritetit institucional është në raport me jetëgjatësinë e këtij institucioni, sfidat e tij, dhe risitë që ky institucion ka sjellë në reformën e drejtësisë në vendin tonë. Gjithsesi, nisur për nga rëndësia dhe roli i KLP-së, është e rëndësishme zbatimi në praktikë i të gjitha akteve dhe rregulloreve të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në nivelin e integritetit institucional.

Shumatorja e pikëve të vlerësimit është **67.5** pikë nga 100 pikë në total.

Nisur nga rezultatet e pikëzimit sipas fushave dhe kriterëve, janë përpunuar disa rekomandime që synojnë rritjen e transparencës, llogaridhënies, meritokracisë, etikës dhe forcimin e integritetit institucional në përgjithësi.

I. LLOGARIDHËNIA

Kontrolli ligjor dhe institucional	Verifikimi	Pikët maksimale	Vlerësimi	Shënime Metodologjike
Transparenca proaktive	Publikimi në faqen zyrtare të internetit i kontakteve për Koordinatorin për të Drejtën e Informimit	2	2	Në faqen e internetit janë të publikuar kontaktet e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit (emri, mbiemri, adresa e email-it), si dhe ka edhe të dhëna për vendndodhjen e zyrave të KLP dhe orarin e punës https://klp.al/koordinatori-per-te-drejten-e-informimit-ne-klp/
	Publikimi nga institucioni i rregullores së brendshme të miratuar.	2	2	Nëpërmjet Vendimit Nr. 405, datë 28.12.2023 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është miratuar Rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e administratës të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, që është botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 9, datë 16.01.2024 dhe gjendet e publikuar ne faqen zyrtare te KLP-së. https://klp.al/2024/01/16/per-miratimin-e-rregullores-per-organizimin-dhe-funksionimin-e-administrates-se-keshillit-te-larte-te-prokurorise/
Kuadri konsultativ	Publikimi i planit vjetor i konsultimeve publike.	2	2	Ky tregues nuk është i aplikueshëm në rastin e KLP-së, pasi në bazë të ligjit Këshilli nuk ndërmerr nisma ligjore. Kompetencën për ligjet që rregullojnë fushat në përgjegjësi të Këshillit e ka Ministria e Drejtësisë, e cila është përgjegjëse për planifikimin dhe mbarëvajtjen e procesit të konsultimit. Në këtë kontekst, planet përkatëse të konsultimit përgatiten nga kjo e fundit. Bazuar ne Nenin 178 të Ligjit Nr. 115/2016, “Për qeverisjen e organeve te drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë është përgjegjës për të shprehur mendime dhe për të bërë propozime lidhur me ndryshimet në legjislacionin që mund të ndikojë në punën e prokurorisë dhe çdo çështje tjetër që është nën përgjegjësinë e Këshillit. Deri tani, Këshilli nuk ka ndërmarrë vetë ndonjë propozim për ndryshime në kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë e tij. Por, Këshilli ka dhënë mendime për ndryshimet në ligje të rëndësishme që ndikojnë apo lidhen me sistemin e drejtësisë dhe përgjegjësitë e tij, të ardhura për mendim nga Ministria e Drejtësisë.

Kontrolli ligjor dhe institucional	Verifikimi	Pikët maksimale	Vlerësimi	Shënime Metodologjike
	Institucioni ka të arkivuara procesverbalet e takimeve konsultative, mendimet dhe sugjerimet e marra nga platformat online të konsultimit publik.	2	2	Ky tregues nuk është i aplikueshëm në rastin e KLP-së, sipas sqarimeve të mësipërme. Gjithsesi, është për t'u vlerësuar fakti që, përpara miratimit, Këshilli dërgon projekt-aktet e hartuara dhe në përgjegjësi të tij, për mendim tek grupet e interesit, institucionet e drejtësisë apo dhe tek organizmat e huaja që ofrojnë asistencë teknike. Konsultimi bëhet përmes korrespondencave me e-mail, ose tryeza të përbashkëta pune, ku marrin pjesë anëtarët e komisioneve përgjegjëse të Këshillit dhe ku njësia e mbështetjes së komisioneve luan rolin e Koordinatorit të Konsultimit Publik. Mendimet dhe sugjerimet, sipas rastit, merren në konsideratë, gjatë hartimit dhe dokumentohen, duke u përmbledhur dhe përgatitur dosjen/ praktikën administrative përkatëse.
	Publikimi i Raportit Vjetor të Konsultimit Publik.	2	2	Nuk aplikohet, për shkak të mungesës së nismës ligjore, sipas sqarimeve të mësipërme.
Kontrolli ligjor dhe institucional		10	10	

Kontrolli i zbatimit në praktikë	Verifikimi	Pikët maksimale	Vlerësimi	Shënime Metodologjike
Transparenca e institucionit	Programi i Transparencës së institucionit është i plotësuar dhe i përditësuar.	2	1	<p>Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk ka informacion në 2 rubrika. Konkretisht, në rubrikën “Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të AP” dhe në atë “Ndihma shoqërore/ subvencione të dhëna nga AP”. Lidhur me rubrikën e parë, siç u shpjegua edhe me sipër, me ligj Këshilli nuk ndërmerret nisma ligjore dhe nuk kryen procesin e konsultimit publik.</p> <p>Ndërkohë, rubrika tjetër “Ndihma shoqërore/ subvencione të dhëna nga AP” nuk është e aplikueshme në rastin e veprimtarisë së KLP-së. Po ashtu, konstatohet se jo të gjitha informacionet brenda rubrikave janë të pajisura me të dhënat përkatës. Arsye e mangësive të mësipërme është fakti se KLP është një institucion relativisht i ri, me një sërë sfidash dhe përparësish që me periudhën e krijimit të tij dhe ka ende nevojë të konsolidohet lidhur me praktikën e punës.</p>
	Raporti i kërkesave për informim që kanë marrë përgjigje kundrejt totalit të kërkesave për informim që i janë drejtuar institucionit.	1	1	Nga konsultimi i Regjistrimit të Kërkesave për Informim, të publikuar në Programin e Transparencës, rezultojnë që të gjitha kërkesat për informacion të dërguara pranë Këshillit kanë marrë përgjigje si për vitin 2023 ashtu edhe për vitin 2024.
	Numri mesatar i ditëve për kthimin e përgjigjes ndaj kërkesave për informacion.	1	1	<p>Për vitin 2023, rezultojnë që mesatarja e kohës së kthimit të përgjigjes për kërkesat për informacion është 8.86 ditë.</p> <p>Për vitin 2024 (gjashtëmujori i parë: periudha janar –korrik 2024) rezultojnë se numri mesatar i ditëve për të kthyer përgjigje për kërkesat për informim është 10.03 ditë. Megjithatë, duhet cilësuar se në 75% të rasteve ky afat është më i vogël sesa 10 ditë edhe për vitin 2024.</p>

Kontrolli i zbatimit në praktikë	Verifikimi	Pikët maksimale	Vlerësimi	Shënime Metodologjike
	Institucioni vë në dispozicion të publikut një faqe dinamike interneti ku ofrohet informacion i përditësuar dhe publiku informohet në kohë.	2	2	KLP në faqen e tij të internetit ka të publikuar raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit, për çdo vit që nga krijimi i tij, përfshirë atë të një viti më parë (vitit 2023), si dhe atë të katërmujorit të parë të vitit aktual (viti 2024). https://klp.al/wp-content/uploads/2024/06/Raport-Monitorimi-i-vitit-2023-i-Këshillit-te-Larte-te-Prokurorise.pdf https://klp.al/wp-content/uploads/2024/06/Raport-Monitorimi-4-Mujori-2024.pdf
	Raporti mes planit vjetor të konsultimit publik kundrejt realizimit të konsultimit publik.	2	2	Ky tregues nuk është i aplikueshëm në rastin e KLP-së, pasi në bazë të ligjit, institucioni nuk ndërmerr nisma ligjore. Për ligjet që rregullojnë fushat në përgjegjësi të Këshillit, procesi i konsultimit kryhet nga Ministria e Drejtësisë. Këshilli mund të bashkërendojë me Ministrinë e Drejtësisë për të propozuar ndryshime ligjore që ndikojnë në fushat në përgjegjësi të tij. Ky bashkërendim nuk ka ndodhur deri tani, ndaj ndikimi i konsultimit në politikëbërje nuk mund të matet. Megjithatë, Këshilli konfirmon që aktet nënligjore e administrative, të hartuara prej tij, konsultohen me prokurorë, OJF dhe partnerë ndërkombëtarë, nëpërmjet komisioneve përkatëse. Për këto të fundit, nuk ka raporte konsultimi të bëra publike, por Këshilli konfirmon që mendimet dhe sugjerimet bëhen pjesë e dosjes dhe merren për bazë, sipas vlerësimeve të Këshillit, për sa është e mundur. Për të vlerësuar ndikimin e konsultimeve të bëra nga Këshilli për aktet nënligjore të nxjerra prej tij, sugjerohet që rezultatet e konsultimit të bëhen publike.

Kontrolli i zbatimit në praktikë	Verifikimi	Pikët maksimale	Vlerësimi	Shënime Metodologjike
	Numri i aktiviteteve të konsultimit publik të pasqyruara në procesverbale kundrejt numrit total të aktiviteteve konsultuese të organizuara.	1	1	Siç u sqarua më sipër, KLP, nuk ndërmerr nisma ligjore. Për pasojë, ky tregues nuk mund të zbatohet këtu.
	Numri i komenteve dhe sugjerimeve të marra nga aktivitetet e konsultimit publik të pranuar kundrejt numrit total të rekomandimeve/ sugjerimeve të dhëna gjatë konsultimit publik.	1	1	Siç u sqarua më sipër, KLP nuk ndërmerr nisma ligjore. Rrjedhimisht, ky tregues nuk mund të përdoret në këtë pikë.
Kontrolli i zbatimit në praktikë		10	9	
Totali i Vlerësimit		20	19	

1. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Llogaridhënia është e lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me transparencën. Prandaj, është e rëndësishme që institucionet t'i kushtojnë rëndësinë e duhur. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka rolin kryesor në qeverisjen e sistemit të prokurorisë. Në këtë këndvështrimi, transparencë proaktive e Këshillit merr një rol themelor në rritjen e besimit të publikut te ky institucion, te trupa e prokurorëve dhe te drejtësia në përgjithësi.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në cilësinë e tij si autoritet publik, duhet të përmbushë detyrimet e tij për transparencë ndaj publikut edhe në kuadër të detyrimeve që i rrjedhin nga Ligji Nr. 119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar. Konkretisht në bazë të neni 7 të ligjit të sipërcituar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka përgatitur Programin e Transparencës, nëpërmjet të cilit realizohet transparencë proaktive. Kjo e fundit i shërben qytetarit dhe çdo pale të interesuar për t'u njohur me veprimtaritë e Këshillit si dhe për të monitoruar apo vlerësuar punën e tij.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka filluar funksionimin e tij në fund të vitit 2018 dhe Programi i Transparencës është përgatitur në vitin 2022. Edhe pse një pjesë e informacioneve të Programit të Transparencës kanë qenë në faqen zyrtare të Këshillit qysh me konstituimin e tij, koha e përgatitjes së Programit konsiderohet relativisht e gjatë. Por, që prej krijimit, Programi i Transparencës vijon të jetë në plotësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Referuar Indeksit të Transparencës Proaktive të Institucioneve Qendrore dhe të Varësisë, të përgatitura nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2023, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, vlerësohej 7.5 nga 10 pikë të mundshme.² Konstatohet që edhe elementët që nuk kishin marrë pikë apo vlerësoheshin me pikë jo të plota në Indeksin e Transparencës aktualisht janë plotësuar.

Në Programin e Transparencës gjenden informacionet bazë që pasqyrojnë veprimtarinë e Këshillit. Institucioni ka vendosur në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit emrin dhe kontaktet e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, si dhe orarin e punës.³

Në dhjetor të vitit 2023, Këshilli miratoi Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e cila gjendet e publikuar si pjesë e Programit të Transparencës, në rubrikën e legjislacionit.⁴ Koha e miratimit të këtij akti, rreth 4 vite nga konstituimi, mund të konsiderohet e vonuar.

Sa i takon kuadrin konsultativ, duhet theksuar se Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk ndërmerr nisma ligjore. Detyrimin për organizimin e procesit të konsultimit publik për ligjet që rregullojnë sistemin e drejtësisë dhe ndërmarrjen e nismave ligjore e ka Ministria e Drejtësisë, e për rrjedhojë, procesi i konsultimit për këto akte planifikohet dhe realizohet nga kjo e fundit. Megjithatë, bazuar në Ligjin Nr. 115/2016, "Për qeverisjen e organeve të drejtësisë", i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë është përgjegjës për të shprehur mendime dhe për të bërë propozime lidhur me ndryshimet në legjislacionin që mund të ndikojë në punën e prokurorisë dhe çdo çështje tjetër që është nën përgjegjësinë e Këshillit⁵. Deri tani, Këshilli nuk ka ndërmarrë vetë ndonjë propozim për ndryshime në kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë e tij. Por, Këshilli ka dhënë mendime për ndryshimet në ligje të rëndësishme që ndikojnë apo lidhen me sistemin e drejtësisë dhe përgjegjësitë e tij, të ardhura për mendim nga Ministria e

2 Shih për më tepër Indeksin e Transparencës Proaktive të Institucioneve Qendrore dhe Të Varësisë, fq. 14 https://idp.al/wp-content/uploads/2024/03/2023_Indeksi_i_transparences_autoritete_qendrore_varesia.pdf

3 Shih për më tepër publikimin në <https://kplp.al/koordinatori-per-te-drejte-e-informimit-ne-kplp/>

4 Shih në <https://kplp.al/2024/01/16/per-miratimin-e-rregullores-per-organizimin-dhe-funksionimin-e-administrates-se-keshillit-te-larte-te-prokurorise/>

5 Shih nenin 187 të Ligjit Nr. 115/2016 "Për qeverisjen e organeve të drejtësisë", i ndryshuar,

Drejtësisë⁶.

Për shkak të mungesës së autoritetit për të ndërmarrë nisma ligjore, në rubrikën e konsultimit publik të Programit të Transparencës nuk ka të dhëna për Planin apo Raportin e Konsultimeve, procesverbalet e takimeve konsultative, apo mendime e sugjerime të marrë nga platformat online të konsultimit publik. Për sa kohë që nisma për legjislacionin që rregullon fushën në përgjegjësi të Këshillit i takon Ministrisë së Drejtësisë, kjo e fundit është përgjegjëse për organizimin e procesit e konsultimit publik, dokumentimin dhe transparencën e tij.

2. KONTROLLI I ZBATIMIT NË PRAKTIKË

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka hartuar Programin e Transparencës dhe e ka të publikuar atë në faqen e tij të internetit (<https://klp.al/>). Në këtë Program jepet informacion dhe të dhëna për:

- » Institucionin, si funksionet dhe detyrat e autoritetit publik, strukturën organizative të institucionit, të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve;
- » Tekstet e ligjeve dhe të akteve nënligjore;
- » Procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- » Vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet koordinatorit për të drejtën e informimit;
- » Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi KLP-në;
- » Buxhetin dhe raportet për zbatimin e tij;
- » Parashikimet dhe realizimin e prokurimit;
- » Listën e dokumenteve që administrohen me afatet e ruajtjes;
- » Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve;
- » Informacione apo të dhëna që kërkohen më shpesh.

Vihet re se informacioni i publikuar është i përditësuar.

Nga ana tjetër, vihet re se mungon informacioni në rubrikën “Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të AP” si dhe në atë “Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga AP”. Mungesa në rubrikën e parë, siç u sqarua edhe me sipër, lidhet me mungesën e kompetencës së Këshillit për të ndërmarrë nisma ligjore. Ndërkohë, rubrika “Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga AP” nuk është e aplikueshme në rastin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Po ashtu, konstatohet se jo të gjitha lidhjet/adresat brenda rubrikave janë të pajisura me informacionin përkatës. Arsye e këtyre mangësive është fakti se Këshilli është një institucion relativisht i ri, me një sërë sfidash dhe përparësish që nga momenti i krijimit dhe ka ende nevojë të konsolidojë praktikën e punës.

6 Mendimi i dhënë me shkresën Nr. 2056/1, datë 30.03.2023, “Dërgohet një projektligj për mendim”, të Ministrisë së Drejtësisë si dhe Shkresën Nr. 761/1, datë 07.04.2023, “Kthim përgjigje”, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Sa i takon garantimit të të drejtës së informimit mbi bazë të kërkesave rezulton se KLP mban, sipas formatit të rekomanduar nga Komisioneri, Regjistrin e Kërkesave dhe e ka të publikuar atë në Programin e Transparencës. Rezulton që të gjitha kërkesat për informacion të dërguara pranë Këshillit kanë marrë përgjigje si për vitin 2023 ashtu edhe për vitin 2024. Për vitin 2023, rezulton që koha mesatare për kthimin e përgjigjes për kërkesat për informacion është 8.86 ditë. Për vitin 2024, deri në momentin e monitorimit (korrik 2024) rezulton se numri mesatar i ditëve për të kthyer përgjigje për kërkesat për informim është 10.03 ditë. Megjithatë, duhet cilësuar se bëhet fjalë ende për gjashtëmujorin e parë. Gjithsesi, edhe për këtë vit, në 75% të rasteve ky afat është më i vogël se 10 ditë.

Sa i përket transparencës financiare, Këshilli i Lartë i Prokurorisë në faqen e tij të internetit ka të publikuar raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për çdo vit që nga krijimi i tij, përfshirë atë të një viti më parë (vitit 2023), si dhe atë të katërmujorit të parë të vitit aktual (viti 2024). Megjithatë, jo çdo monitorim katërmujor i viteve të mëparshme gjendet i publikuar.

Procesi i konsultimit publik, për shkak se KLP nuk ndërmerr nisma ligjore, nuk ka informacion në programin e transparencës. Për ligjet që rregullojnë fushat në përgjegjësi të Këshillit, procesi i konsultimit kryhet nga Ministria e Drejtësisë. Aktualisht Këshilli mund të bashkërendojë me Ministrinë e Drejtësisë për të propozuar ndryshime ligjore që ndikojnë në fushat në përgjegjësi të tij. Deri më sot ky bashkërendim nuk ka ndodhur. Megjithatë, Këshilli ka dhënë mendim për aktet e propozuara që ndikojnë në veprimtarinë e tij dhe që janë dërguar për mendim.

Nga ana tjetër, në kuadër të kompetencës që Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka për të nxjerrë akte administrative, që rregullojnë fushat në përgjegjësi të vet⁷, Këshilli konfirmon që, përpara miratimit projekt-aktet dërgohen për mendim tek grupet e interesit, institucionet e drejtësisë apo dhe organizmat e huaj që ofrojnë asistencë teknike⁸. Konsultimi bëhet përmes korrespondencave me email, ose edhe tryezave të përbashkëta të punës, ku marrin pjesë anëtarët e komisioneve përgjegjëse të Këshillit. Mendimet dhe sugjerimet, sipas rastit, merren në konsideratë, gjatë hartimit dhe dokumentohen, duke u përmbledhur dhe bërë pjesë e dosjes/praktikës administrative përkatëse. Në kuadër të rritjes së transparencës dhe vlerësimit të ndikimit në politikëbërje, aktiviteti i konsultimit dhe dokumentacioni përkatës për këto akte sugjerohet të bëhet publik.

3. REKOMANDIME PËR LLOGARIDHËNIEN

Në kuadër të përmirësimit të llogaridhënies dhe transparencës, rekomandohet që:

- » Programi i Transparencës të plotësohet në të gjitha rubrikat, për aq sa është e aplikueshme në rastin e KLP-së, me informacion të përditësuar.
- » Për rubrikat të cilat nuk gjejnë zbatim në rastin e Këshillit, për qartësi të publikut, mund të bëhet një sqarim i këtij fakti.
- » Edhe pse Struktura e Programit të Transparencës është standarde për çdo institucion, informacioni në faqen zyrtare dhe në Programin e Transparencës duhet të organizohet më qartë, me qëllim për të qenë me i kuptueshëm dhe aksesueshëm.
- » Edhe pse vetë Këshilli nuk është organ që mund të ndërmarrë nisma ligjore dhe, rrjedhimisht, nuk ka përgjegjësi për organizimin dhe dokumentimin e konsultimit publik, në rubrikën përkatëse të konsultimit publik mund të shihet mundësia e publikimit të mendimeve të dhëna

7 Projekt-akte administrative, si p.sh., rregullorja për marrëdhëniet me publikun dhe media, ndryshimet në rregulloren e vlerësimit etik dhe profesional, draft-rregullorja për bashkimin e procedimeve disiplinore, konfirmohen nga Këshilli që i janë nënshtruar procesit të konsultimit.

8 Aktet e nxjerra nga Këshilli, bazuar në kompetencat e tij ligjore, janë konsultuar me median, prokurorët, KLGJ, ILD, OPDAT, apo dhe programin EU4JUSTICE që ofron asistencë teknike

nga Këshilli, për projektaktet e dërguara për mendim nga institucionet e tjera. Gjithashtu, në kuadër të vlerësimit të ndikimit në politikëbërje, në këtë rubrikë mund të pasqyrohet dhe të dokumentohet procesi i konsultimit, i bërë për aktet nënligjore në kompetencë të Këshillit.

- » Sa i takon transparencës financiare, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, duhet të publikohen rregullisht, për çdo katërmujor.
- » Në çdo rast, të respektohen afatet e përgjigjeve për kërkesat për informacion drejtuar Këshillit.

II. TRANSPARENCA PROAKTIVE

Kontrolli ligjor dhe institucional	Objektivi i Vlerësimit/ Mënyra e Verifikimit	Pikët maksimale	Vlerësimi	Shënime metodologjike
Mekanizmat e llogaridhënies	Programi i Transparencës përmban planin vjetor dhe raportin vjetor të miratuar të institucionit publik.	1	1	<p>Në faqen zyrtare në internet të institucionit (www.klp.al) si dhe në Programin e Transparencës https://klp.al/wp-content/uploads/2024/07/Programi_i_transparences.1-1.html, janë të publikuara akte të brendshme, dokumente strategjike si dhe raportime të ndryshme, si më poshtë:</p> <p>Rregullorja e Brendshme e KLP-së: https://klp.al/2021/12/22/per-organizimin-dhe-funksionimin-e-brendshem-te-keshillit-te-larte-te-prokurorise/</p> <p>Raporti Vjetor i Aktivitetit: https://klp.al/raportime/</p> <p>Plani Buxhetor Afatmesëm: https://klp.al/wp-content/uploads/2024/06/Programi-Buxhetor-Afatmesem-PBA-2025-2027-i-KLP.pdf</p> <p>Regjistri i Parashikimeve të Prokurimeve për 2024: https://klp.al/wp-content/uploads/2024/06/Regjistri-i-Parashikimeve-te-Prokurimit-Publik-2024-i-Keshillit-te-Larte-te-Prokurorise.pdf.</p> <p>Regjistri i Realizimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2023: https://klp.al/wp-content/uploads/2024/06/Regjister-i-Realizimeve-te-Prokurimeve-Publike-2023-i-Keshillit-te-Larte-te-Prokurorise.pdf</p> <p>Lidhur me Raportin e Monitorimit të PBA-së nuk është përmbyllur akoma, pasi viti 2024 është akoma në zbatim: https://klp.al/wp-content/uploads/2022/05/PBA-2022-2024.pdf</p> <p>Rezolutat e miratuara dhe publikuara nga Kuvendi për veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, përfshirë këtu edhe Rezolutën e vitit 2023, janë publikuar në faqen zyrtare Rezolute-e-KLP-se-2023.pdf</p>

Kontrolli ligjor dhe institucional	Objektivi i Vlerësimit/ Mënyra e Verifikimit	Pikët maksimale	Vlerësimi	Shënime metodologjike
	Evidentohen dallime në zbatimin e aktiviteteve (krahasuar me planin). Në raportin vjetor të monitorimit të buxhetit, raporti fakt/plan është >85%.	1	1	Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka nisur planin buxhetor për vitin 2023 me fondet e akorduara në vlerën 172,600,000. Referuar VKM Nr. 325, datë 31.05.2023, "Për miratimin e strukturave të pagave", Këshillit të Lartë të Prokurorisë iu shtua fondi për paga dhe sigurime, duke e çuar Planin e Buxhetit për periudhën janar – dhjetor 2023 në vlerën 202,585,500 lekë. Realizimi faktik për periudhën janar –dhjetor 2023 është në vlerën 200,919,057 lekë ose 99%.
Auditi i jashtëm	Institucioni ka kaluar një auditim të jashtëm (KLSH/Autoritete Mbikëqyrëse/ BE/ Auditues të Pavarur) në tre vitet e fundit.	1	1	Veprimtaria ekonomike dhe financiare e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për periudhën 01.01.2022-31.12.2023 ka qenë objekt kontrolli nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Në përfundim të kontrollit nga ana e KLSH është përgatitur dhe Raporti Përfundimtar i Auditit për auditimin e ushtruar, i cili është vënë në dispozicion nga KLP.
	Raporti i Auditimit të fundit të jashtëm është i publikuar nga institucioni, duke përfshirë edhe listën e rekomandimeve.	1	1	Raporti Përfundimtar i Auditimit Financiar për KLP është i publikuar, përfshirë dhe publikimin e rekomandimeve (fq. 53 - 57): https://kpl.al/wp-content/uploads/2024/06/Raporti-i-Auditimit-nga-KLSH-i-vitet-2024-per-periudhen-2022-2023.pdf

Kontrolli ligjor dhe institucional	Objektivi i Vlerësimit/ Mënyra e Verifikimit	Pikët maksimale	Vlerësimi	Shënime metodologjike
	Institucioni ka përgatitur planin e trajtimit të rekomandimeve bazuar në raportin e fundit të auditimit të jashtëm.	1	0	Institucioni po ndërmerr veprime lidhur me masat organizative që do të merren në përputhje me Raportin Përfundimtar të Auditit të lënë nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit, por nuk rezulton të jetë përgatitur ndonjë plan masash për trajtimin apo zbatimin e rekomandimeve.
Auditi i brendshëm	Dokumenti i Kartës së Auditimit (statusi i organizatës, qëllimi, misioni, objektivat e punës, llogaridhënia dhe përgjegjësitë e njësisë së auditimit të brendshëm) është hartuar dhe miratuar.	1	1	Këshilli i Lartë i Prokurorisë është organ i parashikuar nga Kushtetuta dhe veprimtaria e tij rregullohet nga ligje të posaçme organike, si ligji për qeverisjen dhe ligji për statusin, apo aktet e brendshme nënligjore që shërbejnë si bazë e veprimtarisë së institucionit: https://klp.al/paketa-ligjore/ https://klp.al/category/akte-nenligjore-te-klp/ Institucioni nuk ka një njësi të brendshme auditi. Rrjedhimisht, edhe Dokumenti i Kartës së Auditimit me të gjithë elementët përbërës të përshkruar nuk ekziston, pasi nuk është i aplikueshëm.
	Rregullat e sjelljes dhe parimet që duhet të udhëheqin punën e auditorëve të brendshëm si dhe plani i punës janë hartuar, miratuar dhe vënë në zbatim.	1	1	Në nenin 178, të Ligjit Nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" parashikohet organizimi i administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas së cilës është ndërtuar dhe organigrama aktuale e KLP-së. Ngritja e Njësisë së Auditit të Brendshëm nuk është e parashikuar në këtë organigramë.

Kontrolli ligjor dhe institucional	Objektivi i Vlerësimit/ Mënyra e Verifikimit	Pikët maksimale	Vlerësimi	Shënime metodologjike
Matja e kënaqshmërisë së klientit	Ekziston një sistem i monitorimit të vazhdueshëm të kënaqësisë së klientit; ka evidenca se gjetjet e këtij vlerësimi janë të përfshira në planin operativ/ programin e punës.	1	0	KLP nuk ka kryer asnjëherë një studim të tillë.
	Të sigurohen evidenca se gjetjet e këtij vlerësimi janë të përfshira në planin operativ/ programin e punës.	2	0	Një studim i tillë nuk ekziston. Rrjedhimisht, rekomandimet e tij nuk janë pjesë e planit vjetor të institucionit.
Kontrolli ligjor dhe institucional		10	6	
Kontrolli i zbatimit në praktikë				
Funksionaliteti i mekanizmave të llogaridhënies horizontale dhe vertikale	Institucioni ka të paktën një autoritet mbikëqyrës, në të cilin raporton në mënyrë periodike.	1	1	Në mbështetje të nenit 181 të Ligjit Nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" realizohet publikimi për publikun dhe para Kuvendit, ku Këshilli Lartë i Prokurorisë raporton për gjendjen e sistemit gjatë vitit të mëparshëm kalendarik jo më pak se një herë në vit. Raporti i përcillet Kuvendit jo më vonë se data 1 maj e çdo viti. Raporti publikohet në faqen zyrtare të Këshillit, si dhe me çdo mënyrë tjetër që vlerësohet e përshtatshme nga Këshilli.

Kontrolli ligjor dhe institucional	Objektivi i Vlerësimit/ Mënyra e Verifikimit	Pikët maksimale	Vlerësimi	Shënime metodologjike
	Institucioni përgatit të paktën një raport vjetor, i cili shqyrtohet dhe miratohet nga autoriteti mbikëqyrës i tij dhe bëhet publik.	1	1	Në mbështetje të nenit 181 të Ligjit Nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", raporti vjetor i përcillet Kuvendit jo më vonë se data 1 maj e çdo viti. Raporti publikohet në faqen zyrtare të Këshillit, si dhe me çdo mënyrë tjetër që vlerësohet e përshtatshme nga Këshilli. Këshilli raporton në çdo rast tjetër që e vlerëson të nevojshme ose me kërkesë të Kuvendit.
	Institucioni përgatit nëpërmjet ekspertëve të jashtëm raport të monitorimit të planit vjetor ose strategjisë sektoriale (të paktën njëherë në tre vjet).	2	1	Aktualisht Këshilli i Lartë i Prokurorisë po zbaton Planin Strategjik 2021-2024. Monitorimi i zbatimit të këtij plani strategjik është bërë nga strukturat përkatëse të Këshillit dhe raporti i detajuar i miratuar nga Komisioni i Planifikimit, Administrimit dhe Buxhetit si dhe nga Këshilli është publikuar në faqen zyrtare të institucionit. https://klp.al/wp-content/uploads/2024/06/Raporti-i-Komisionit-te-Planifikimit-dhe-Buxhetit-2023.pdf Nuk ka një raport monitorimi të posaçëm, por është pjesë përbërëse e raportimit të Komisionit të Planifikimit, Administrimit dhe Buxhetit.
	Nga vlerësimi i raportit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit të jashtëm të fundit rezulton se 80% e rekomandimeve janë trajtuar nga një plan veprimi i miratuar dhe bërë publik.	2	0	Nuk rezulton që institucioni të këtë një plan veprimi ku të trajtojë masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të përfshira në raportin e auditimit të jashtëm, KLSH.

Kontrolli ligjor dhe institucional	Objektivi i Vlerësimit/ Mënyra e Verifikimit	Pikët maksimale	Vlerësimi	Shënime metodologjike
	Nga vlerësimi i raportit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm (i një viti më përpara) rezulton se 80% e rekomandimeve janë trajtuar nga një plan veprimi i institucionit.	2	0	Nuk rezulton që institucioni të ketë një njësi auditimi të brendshëm. Rrjedhimisht, nuk kryhet asnjë audit i brendshëm.
	Ka dispozita të shumta për të siguruar që institucioni realizon përgjegjësitë e tij të prokurimit publik në mënyrë të ligjshme dhe etike. Institucioni publikon Planin e Prokurimeve (0.5 pikë).	0.5	0.5	Institucioni përgatit çdo vit Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike. Në faqen zyrtare të institucionit është publikuar Regjistri i Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2023 si dhe Regjistri i Realizimeve të Prokurimeve Publike, viti buxhetor 2023 (sipas Shkresës Nr. 81, datë 10.01.2024, të Këshillit drejtuar Degës së Thesarit Tiranë, Regjistri i realizimit të prokurimeve 2023.pdf) https://klp.al/wp-content/uploads/2024/06/Regjister-i-Parashikimeve-te-Prokurimeve-Publike-2023-i-Këshillit-te-Larte-te-Prokurorise.pdf https://klp.al/wp-content/uploads/2024/06/Regjister-i-Realizimeve-te-Prokurimeve-Publike-2023-i-Këshillit-te-Larte-te-Prokurorise.pdf
	Raporti mes planit/faktit të prokurimeve është mbi 50%	0.5	0.5	Institucioni konfirmon që raporti mes planit dhe realizimit faktik të prokurimeve për vitin 2023 është në masën 95%.

Kontrolli ligjor dhe institucional	Objektivi i Vlerësimit/ Mënyra e Verifikimit	Pikët maksimale	Vlerësimi	Shënime metodologjike
	Raporti prokurime të drejtpërdrejta (në vlerë) kundrejt totalit të prokurimeve është <25% (0.5 pikë).	0.5	0.5	Institucioni konfirmon që raporti i prokurimeve të drejtpërdrejta për vitin 2023 është në masën 16%. Pra, është më i vogël se 25%.
	Raporti numri i kontratave me probleme kundrejt totalit të kontratave është < 25% (0.5 pikë).	0.5	0.5	Institucioni konfirmon që nuk ka kontrata prokurimi me probleme për asnjë operator që në procedurën e prokurimit ka rezultuar fitues.
Kontrolli i zbatimit në praktikë		10	5	
Vlerësimi Total		20	11	

1. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Raporti Vjetor i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023 ka theksuar që buxheti dhe burimet e KLP janë rritur, por konstatohen ankesa nga media dhe shoqëria civile lidhur me transparencën. Për këtë qëllim, raporti thekson që është e rëndësishme të përmirësohet kuadri rregullator për të krijuar një praktikë të mirë-përcaktuar lidhur me komunikimin me median dhe aksesin në informacion, bazuar në parimin e transparencës⁹.

Duke pasur parasysh faktin që KLP është një institucion relativisht i ri, mekanizmat e llogaridhënies janë të plotë dhe të detajuar, duke paraqitur një panoramë të gjerë të kuadrit ligjor dhe institucional. Në faqen zyrtare të KLP-së si dhe në Programin e Transparencës janë të publikuara dokumentet strategjike, akte të brendshme, si dhe raportime të ndryshme, si pjesë e mekanizmave të llogaridhënies, të tilla si Rregullorja e Brendshme e KLP-së, raportet vjetore¹⁰, Plani Buxhetor Afatmesëm (PBA) për periudhën 2025-2027¹¹, Regjistri i Parashikimeve të Prokurimeve për vitin 2024¹², etj. Gjithashtu, në Programin e Transparencës është përfshirë dhe Regjistri i Realizimeve të Prokurimeve Publike për periudhën 2019-2021¹³ si dhe ai i vitit 2023 që është vënë në dispozicion nga KLP¹⁴. Lidhur me Raportin e Monitorimit të PBA-së, nuk është përmbyllur akoma, pasi viti 2024 është akoma në zbatim.

Rezolutat e miratuara dhe publikuara nga Kuvendi i Shqipërisë për veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë janë një tjetër mekanizëm llogaridhënieje, të cilin institucioni e ka bërë transparent, përmes publikimit të tyre për periudhën 2019-2023¹⁵. Duke pasur parasysh që institucioni është funksional që prej vitit 2019, viti i parë i plotë i raportimit për aktivitetin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për të cilin është miratuar rezolutë nga ana e Kuvendit, është viti 2019. Pas miratimit nga Kuvendi, edhe rezoluta për veprimtarinë e vitit 2023 është publikuar në faqen zyrtare.

Lidhur me auditin e jashtëm, veprimtaria e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sa i takon aspektit ekonomik dhe financiar për periudhën 01.01.2022-31.12.2023, ka qenë objekt auditimi nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Ky i fundit ka dërguar Raportin Përfundimtar të Auditit për auditimin e ushtruar. Ky raport, së bashku me rekomandimet përkatëse të paraqitura në fq. 53-57, është publikuar në faqen zyrtare të institucionit¹⁶. Por ajo që konstatohet është fakti që nuk ekziston një plan masash për trajtimin e duhur të rekomandimeve. Gjithsesi, institucioni konfirmon që po merren masa organizative lidhur me rekomandimet e lëna në raportin përfundimtar të auditit.

Lidhur me auditin e brendshëm, neni 178¹⁷ i Ligjit Nr. 115/2026, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, parashikon organizimin e administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Organigrama aktuale e këshillit është ndërtuar në përputhje me parashikimet e këtij ligji. Për rrjedhojë, në KLP nuk është krijuar Njësia e Auditit të Brendshëm.

Lidhur me Dokumentin e Kartës së Auditimit që parashikohet në Ligjin Nr. 114/2015, "Për auditimin e

9 Albania Report 2023.pdf Buxhetet dhe burimet njerëzore të KLGJ-së dhe KLP-së janë rritur gradualisht. Ka ankesa të përsëritura nga media dhe shoqëria civile për transparencën dhe shtrirjen. Është e nevojshme të përmirësohet kuadri rregullator dhe praktika e mirë-vendosur për komunikimet me median dhe aksesin në informacion, bazuar në parimin e transparencës.

10 RAPORTE – KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË (klp.al)

11 <https://klp.al/wp-content/uploads/2024/06/Programi-Buxhetor-Afatmesem-PBA-2025-2027-i-KLP.pdf>

12 <https://klp.al/wp-content/uploads/2024/06/Regjistri-i-Parashikimeve-te-Prokurimit-Publik-2024-i-Keshillit-te-Larte-te-Prokurorise.pdf>

13 Regjistri i Realizimeve të Prokurimit Publik 2021 – KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË (klp.al)

14 Sipas Shkresës Nr. 81, datë 10.01.2024, të këshillit drejtuar Degës së Thesarit Tiranë. Regjistri i realizimit të prokurimeve 2023

15 Rezolutë e Kuvendit të Shqipërisë – KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË (klp.al)

16 <https://klp.al/wp-content/uploads/2024/06/Raporti-i-Auditimit-nga-KLSH-i-vitit-2024-për-periudhen-2022-2023.pdf>

17 1. Administrata e Këshillit të Lartë të Prokurorisë ndahet, së paku, në njësitë e mëposhtme: a) njësi mbështetëse për çështje të përgjithshme juridike; b) njësi mbështetëse pranë secilit komision të përhershëm të Këshillit; c) njësi mbështetëse për administrimin e buxhetit të Këshillit; ç) zyra e Këshilltarit të Etikës; d) njësi mbështetëse për marrëdhëniet me publikun dhe botimet; dh) njësi mbështetëse për teknologjinë e informacionit; e) njësi mbështetëse për trajnimin e prokurorëve dhe të nëpunësve civilë të sistemit të prokurorisë.

brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, institucioni nuk ka një dokument të tillë, për aq kohë sa nuk ka një Njësi të Brendshme Auditit. Gjithsesi, bazuar në Ligjin Nr. 115/2016, i ndryshuar, neni 178, pika 2, gërma b) në lidhje me administratën, Këshilli vendos për krijimin e njësie të tjera organizative brenda administratës, duke lënë në diskrecion të Këshillit krijimin e njësie të tjera organizative. Pavarësisht kësaj, Këshilli është vetëm në rolin e propozuesit, pasi vendimmarrja për krijimin e çdo njësie tjetër organizative, është në kompetencë të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Nga ana tjetër, krijimi i një njësie të auditit të brendshëm duhet të justifikohet dhe të jetë në përputhje me aktivitetin ekonomiko-financiar të institucionit, dhe për rastin e KLP, një aktivitet i tillë është minimal. Por kjo nuk e përjashton mundësinë që KLP të krijojë mekanizma të tjerë të brendshëm në mënyrë që të realizojë një kontroll të brendshëm, në varësi të burimeve, kapaciteteve, kuadrit ligjor dhe aktivitetit ekonomiko-financiar që ushtron.

Matja e kënaqshmërisë së klientit apo e kënaqësisë së punonjësve në mjediset e punës është një mekanizëm që rrallëherë përdoret në vendin tonë, sidomos në institucionet publike. Përmes kësaj ankete punëdhënësi mbledh reagime nga punonjësit e tij lidhur me nivelin e kënaqësisë së tyre në punë dhe përvojën e përgjithshme në vendin e punës. Qëllimi i këtij mekanizmi është që të identifikohen fushat ku mund të bëhen përmirësime për të rritur kënaqësinë, performancën dhe angazhimin e punonjësve. Aplikimi i mekanizmave të tillë lidhet edhe me qasjen e institucioneve për të qenë të hapur dhe për t’i përqaftuar mekanizma të tillë. Duke qenë se KLP është një institucion relativisht i ri, por shumë i rëndësishëm për nga mision që ka, kënaqësia e punonjësve në punë është thelbësore, dhe kryerja e një ankete të tillë të bërë në mënyrë anonime, mund të sjellë risi në institucionet publike, por njëherazi i shërben vetë institucionit për t’u përmirësuar dhe për të ndikuar pozitivisht në performancën e punonjësve. Sektori i Burimeve Njerëzore mund të jetë i interesuar më së shumti që të sjellë një risi institucionale të tillë, pasi lidhet drejtpërsëdrejti me detyrat dhe përgjegjësitë funksionale të këtij sektori.

2. KONTROLLI I ZBATIMIT NË PRAKTIKË

Ekzistenca dhe funksionaliteti i mekanizmave të llogaridhënies janë ngushtësisht të lidhura me njëra-tjetrën në funksion të një transparence institucionale të plotë dhe proaktive. Nisur nga analiza e informacionit të mbledhur, konstatohet që mekanizmat llogaridhënës për KLP-në janë gjithëpërfshirës dhe funksionalë, në përputhje me kuadrin ligjor rregullator.

Institucioni ka një autoritet mbikëqyrës pranë të cilit raporton në mënyrë periodike. Në mbështetje të nenit 181 të Ligjit Nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, KLP raporton mbi gjendjen e sistemit të prokurorisë gjatë vitit të mëparshëm kalendarik jo më pak se një herë në vit. Raporti i përcillet Kuvendit jo më vonë se data 1 maj e çdo viti, në të cilin përshkruhet veprimtaria e Këshillit dhe Komisioneve, si dhe trajtohen problematika për çështje të ndryshme. Këshilli raporton në çdo rast tjetër që e vlerëson të nevojshme ose me kërkesë të Kuvendit. Raporti publikohet në faqen zyrtare të Këshillit, si dhe me çdo mënyrë tjetër që vlerësohet e përshtatshme nga Këshilli. Rekomandimet e përcjella në rezolutën e miratuar nga Kuvendi për raportin vjetor të Këshillit të Lartë të Prokurorisë janë të detyrueshme për t’u marrë parasysh nga Këshilli.

Lidhur me pjesën e raportimit të buxhetit, të planifikimit të prokurimeve, si dhe të realizimit të këtyre prokurimeve, KLP ka një nivel të mirë transparence, i cili reflektohet në raportimet periodike që janë në Programin e Transparencës. Institucioni konfirmon që raporti mes planit dhe realizimit faktik të prokurimeve për vitin 2023 është në masën 95%, që është një tregues i mirë për institucionin. Një tjetër tregues pozitiv është dhe fakti që raporti i prokurimeve të drejtpërdrejta për vitin 2023 është në masën 16%, si dhe fakti që institucioni nuk ka kontrata prokurimi me probleme për asnjë operator i cili në procedurën e prokurimit ka rezultuar fitues.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka nisur planin buxhetor për vitin 2023 me fondet e akorduara në vlerën 172,600,000. Referuar VKM Nr. 325 datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturave të pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civil dhe disa nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, Këshillit

të Lartë të Prokurorisë iu shtua fondi për paga dhe sigurime. Kjo shtesë fondi e çoi Planin e Buxhetit për periudhën janar-dhjetor 2023 në vlerën 202,585,500 lekë ose 99%.

Institucioni ka publikuar Regjistrin e Parashikimit të Prokurimeve Publike për periudhën 2023-2024, si dhe Regjistrin e Realizimit të Prokurimeve për vitin 2023. Raportet e monitorimit të buxhetit të KLP janë të publikuara rregullisht, për periudhën 2020 – 2023, dhe raport monitorimi 4-mujor 2024¹⁸.

3. REKOMANDIME PËR TRANSPARENCËN PROAKTIVE

- » KLP duhet të hartojë një plan konkret masash lidhur me trajtimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna në Raportin Vjetor të Auditimit, duke përcaktuar dhe strukturën përgjegjëse brenda institucionit për çdo rekomandim të lënë.
- » Krijimi i një mekanizmi të brendshëm të kontrollit financiar është i domosdoshëm dhe nxit transparencën proaktive. Institucionet që nuk kanë elementë të sigurimit dhe të kontrollit të ligjshmërisë në menaxhimin financiar përballen me rreziqe të konsiderueshme që cenojnë integritetin e institucionit.
- » Zbatimi i një ankete për kënaqësinë e punonjësve në mjedisin e punës është një mekanizëm i ri, që do të ndihmonte institucionin të evidentonte fushat që kanë nevojë për përmirësim të mëtejshëm.

18 Buxheti dhe raportime – KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË (klp.al)

III. QASJA STRATEGJIKE

Kontrolli ligjor dhe institucional	Objektivi i vlerësimit / Mënyra e Verifikimit	Pikët maksimale	Vlerësimi	Shënime metodologjike
Planifikimi i operacioneve të institucionit	Institucioni ka të publikuar Planin e Zhvillimit Strategjik të institucionit dhe Planin e Veprimit.	2	2	KLP ka miratuar dhe publikuar në faqen e internetit të institucionit Planin Strategjik 2021-2024 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, pjesë përbërëse e së cilës është dhe Plani i Veprimit 2021-2024, si dhe Matrica e Vlerësimit të Riskut: https://klp.al/wp-content/uploads/2021/01/Plani-Strategjik-2021-2024.pdf .
	Institucioni ka të publikuara Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) ose gjurmët e auditimit për proceset e punës së institucionit	2	2	<p>Procedurat Standarde të Veprimit dhe/ose gjurmët e auditit për proceset e punës së institucionit janë pjesë përbërëse e dokumenteve të ndryshëm, kryesisht me karakter rregullator, të cilat rregullojnë dhe udhëzojnë proceset e punës të administratës së KLP, por edhe organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në zbatim të misionit të tij kushtetues.</p> <p>Rregullore për organizimin dhe funksionimin e administratës së KLP (https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/12/28/405)</p> <p>Rregullore për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të KLP. (Vendim-Nr. -407-dt.-17.12.2021-1.pdf tek www.klp.al)</p> <p>Akte nënligjore që rregullojnë procese pune të administratës së KLP dhe mënyrën e organizimit, funksionimit dhe procese pune për një veprimtari normale të KLP (https://klp.al/category/akte-nenligjore-te-klp/)</p> <p>Raporti Përfundimtar i Auditit për veprimtarinë e KLP për periudhën 01.01.2022-31.12.2023 i publikuar dhe në Programin e Transparencës (https://klp.al/wp-content/uploads/2024/06/Raporti-i-Auditimit-nga-KLSH-i-vitit-2024-per-periudhen-2022-2023.pdf.)</p>

Kontrolli ligjor dhe institucional	Objektivi i vlerësimit / Mënyra e Verifikimit	Pikët maksimale	Vlerësimi	Shënime metodologjike
	Institucioni ka të publikuar raport monitorimi të zbatimit të Planit Strategjik të Institucionit	2	2	Monitorimi i zbatimit të Planit Strategjik të KLP-së realizohet përmes dy raporteve, konkretisht: 1) raporti i Komisionit të Planifikimit, Administrimit dhe Buxhetit, i cili ka hartuar dhe miratuar një raport të hollësishëm lidhur me zbatimin e Planit Strategjik 2021-2024 (https://klp.al/wp-content/uploads/2024/06/Raporti-i-Komisionit-te-Planifikimit-dhe-Buxhetit-2023.pdf); 2) raporti vjetor i Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2023 (fq. 46-47), i cili jep në mënyrë të përmbledhur informacion lidhur me zbatimin e këtij dokumenti (https://klp.al/wp-content/uploads/2024/05/Raporti-Vjetor-2023.pdf).
Planifikimi i menaxhimit të integritetit	Institucioni ka të publikuar Planin e Integritetit, të miratuar dhe përditësuar.	1	1	KLP ka miratuar dhe publikuar në faqen zyrtare të institucionit Planin e Integritetit 2023-2025 miratuar me Urdhrin Nr. 52, datë 02.03.2023, "Për miratimin e Planit të Integritetit të Administratës së KLP-së". https://klp.al/wp-content/uploads/2023/03/PLANI-2023-2025.pdf
	Institucioni ka monitoruar dhe ka hartuar një raport monitorimi të Planit të Integritetit	1	0	Plani i Integritetit i Administratës së KLP-së miratuar me Urdhrin Nr. 52, datë 02.03.2023, është publikuar në faqen zyrtare të institucionit. Monitorimi i Planit të Integritetit është periodik (1-vjeçar). Deri tani nuk është hartuar ndonjë raport monitorimi.

Kontrolli ligjor dhe institucional	Objektivi i vlerësimit / Mënyra e Verifikimit	Pikët maksimale	Vlerësimi	Shënime metodologjike
Zbatimi i sistemit të menaxhimit të integritetit	Institucioni ka ngritur një strukturë të brendshme (grup pune/koordinator) për zbatimin e planit të integritetit.	2	2	Përmes Urdhrit Nr. 52, datë 02.03.2023, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e Planit të Integritetit (https://klp.al/wp-content/uploads/2023/03/PLANI-2023-2025.pdf), në përputhje dhe me nenin 9, pika 3, germa "o", e Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë", miratuar me Vendimin Nr. 405, datë 28.12.2023 (https://klp.al/2024/01/16/për-miratimin-e-rregullores-për-organizimin-dhe-funksionimin-e-administrates-se-këshillit-te-larte-te-prokurorise/)
Kontrolli ligjor dhe institucional		10	9	

Kontrolli i zbatimit në praktikë	Objektivi i vlerësimit / Mënyra e Verifikimit	Pikët maksimale	Vlerësimi	Shënime metodologjike
Menaxhimi organizativ dhe menaxhimi i integritetit kryhet nëpërmjet një qasjeje strategjike	Plani i integritetit për institucionin bazohet në analizën e risqeve ndaj integritetit dhe përmban masa për menaxhimin e tyre.	2	2	Plani i Integritetit në përgjithësi dhe Plani i Veprimit në veçanti bazohen në katër objektiva të qarta të cilat janë në funksion të integritetit dhe transparencës institucionale. Më qëllim që të përmbushet çdo objektivi i përcaktuar, në Planin e Veprimit identifikohen risqet konkrete si dhe masat që duhen marrë me qëllim zbutjen apo minimizimin e këtyre risqeve. Në total, në Planin e Veprimit janë identifikuar 36 risqe, nga të cilat 24 me ndikim "mesatar" dhe 12 me ndikim "të lartë". Për çdo risk të identifikuar, Plani i Veprimit parashikon masa konkrete, një, dy ose më shumë masa të marra në funksion të minimizimit të riskut. Konstatohet që ka një lidhje të qartë dhe të drejtpërdrejtë të risqeve të identifikuara dhe masave të parashikuara, në funksion të plotë dhe përpjesëtimor me përmbushjen e objektivave të parashikuara, duke synuar integritetin institucional të KLP-së.

Kontrolli i zbatimit në praktikë	Objektivi i vlerësimit / Mënyra e Verifikimit	Pikët maksimale	Vlerësimi	Shënime metodologjike
	Numri i masave me rrezik të lartë kundrejt totalit të masave është >25%.	2	2	Në total, Plani i Veprimit ka identifikuar 36 risqe, nga të cilat 24 me ndikim “mesatar” dhe 12 me ndikim “të lartë”. Plani i Veprimit parashikon 79 masa në total për 36 risqet e identifikuara. 29 masa për risqet me ndikim të lartë, dhe 50 masa për risqet me ndikim mesatar. Numri i masave me rrezik të lartë kundrejt totalit të masave është 36.7%.
	Institucioni monitoron zbatimin e planit të integritetit. Raporti i monitorimit tregon se 60% e masave të tij për atë periudhë zbatimi që është në monitorim janë zbatuar.	2	1	Institucioni i KLP deri tani nuk ka hartuar raportin e monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit. Koordinator i përgjegjës është caktuar në muajin korrik. Ndaj, përgatitja e raportit të monitorimit është në proces.
	Raporti i monitorimit përmban rekomandime (të paktën një rekomandim) për përditësimin e planit të integritetit.	2	1	Pavarësisht se KLP nuk ka hartuar akoma një raport monitorimi për zbatimin e Planit të Integritetit, përditësimi i tij parashikohet edhe në vetë Planin e Integritetit ku specifikohet se “Pas monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit, grupi i punës së institucionit do të rishikojë dokumentin dhe do ta përditësojë atë me sfidat e ardhshme” (fq. 12).

Kontrolli i zbatimit në praktikë	Objektivi i vlerësimit / Mënyra e Verifikimit	Pikët maksimale	Vlerësimi	Shënime metodologjike
	Institucioni ka emëruar një person përgjegjës për zbatimin e Planit të Integritetit. Personi përgjegjës ushtron funksionin në bazë të vendimit të emërimit ku specifikohen përgjegjësitë dhe detyrat.	2	2	Përmes Urdhrit Nr. 52, datë 02.03.2023, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e Planit të Integritetit (https://klp.al/wp-content/uploads/2023/03/PLANI-2023-2025.pdf). Me Urdhrin Nr. 111, datë 03.07.2024, "Për caktimin e koordinatorit përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të Urdhrit Nr. 52, datë 02.03.2023, "Për miratimin e planit të integritetit të administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë 2023-2025", të Sekretarit të Përgjithshëm, për monitorimin e zbatimit dhe raportimit të Planit të Integritetit është ngarkuar drejtuesja e Njesisë së Shërbimeve Ligjore pranë KLP-së.
Kontrolli i zbatimit në praktikë		10	8	
Pikët për integritetin strategjik:		20	17	

1. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

KLP është themeluar më datë 19 dhjetor 2018 dhe është për t'u vlerësuar fakti që ka një kuadër ligjor dhe institucional të konsoliduar përse i përket qasjes strategjike. Duke qenë një institucion relativisht i ri, përcaktimi i objektivave strategjike e ndihmon institucionin në përmbushjen e misionit të tij.

Në nëntor 2020 Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka përgatitur, miratuar dhe publikuar në faqen zyrtare të institucionit dokumentin "Plani Strategjik 2021-2024"¹⁹. Ekzistenca e këtij dokumenti strategjik është një zhvillim pozitiv për institucionin. Ky dokument është i gjerë e gjithëpërfshirës dhe paraqet qartë objektivat strategjike të institucionit për periudhën 2021-2024, ndër të cilat më kryesoret renditen: (i) pavarësia; (ii) llogaridhënia; (iii) meritokracia si dhe (iv) efienca e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Pjesë përbërëse e Planit Strategjik është Plani i Veprimit 2021-2024 që synon të garantojë realizimin e objektivave të sipërpërmendura me qëllim përmirësimin e performancës së sistemit të drejtësisë penale dhe rritjen e besimit të publikut tek sistemi. Plani i veprimit parashikon masa dhe aktivitete konkrete, gjithsej 21 aktivitete, në funksionin e objektivave dhe prioriteteve institucionale.

Përmes Urdhrit Nr. 52, datë 02.03.2023, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka përgatitur, miratuar dhe publikuar në faqen zyrtare të institucionit një dokument tjetër të rëndësishëm që lidhet ngushtësisht me integritetin institucional, siç është "Plani i Integritetit i Administratës së KLP-së 2023-2025"²⁰. Ky dokument i brendshëm rregullator me karakter udhëzues për administratën e KLP-së përcakton në mënyrë të qartë objektivat për forcimin e etikës dhe të integritetit, si parime bazë që udhëheqin administratën civile të KLP-së në funksion dhe në shërbim të aktivitetit institucional të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Përgatitja e një dokumenti të tillë është një nismë pozitive e KLP-së drejt etikës dhe integritetit institucional.

Një tjetër hap pozitiv institucional janë dhe Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për procese të ndryshme të punës së institucionit, të cilat janë pjesë përbërëse e dokumenteve të ndryshme, kryesisht me karakter rregullator, për organizimin dhe funksionimin e KLP-së, por njëkohësisht rregullojnë dhe udhëzojnë proceset e punës të administratës së KLP, si më poshtë:

- » Rregullore për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të KLP-së²¹.
- » Rregullore për organizimin dhe funksionimin e administratës të KLP-së²²
- » Akte nënligjore që rregullojnë mënyrën e organizimit, funksionimit dhe proceset e punës për një veprimtari normale institucionale²³.

2. KONTROLI I ZBATIMIT NË PRAKTIKË

Ekzistenca e një kuadri rregullator strategjik, sado i konsoliduar të jetë ky i fundit, nuk do të ishte i plotë nëse nuk realizohet zbatimi në praktikë. Për këtë qëllim është e rëndësishme që institucioni të krijojë mekanizma që nxisin kontrollin e zbatimit të këtij kuadri ligjor dhe institucional në mënyrë periodike.

Pavarësisht se periudha e zbatimit të planit strategjik është 2021-2024, si pjesë e këtij dokumenti janë përfshirë aktivitetet e realizuara dhe ato që pritej të realizoheshin në tremujorin e fundit të 2020, që tregojnë një angazhim serioz të institucionit në qasjen strategjike. Një element tjetër i rëndësishëm është

19 [Plani-Strategjik-2021-2024.pdf \(klp.al\)](#)

20 [PLANI-2023-2025.pdf \(klp.al\)](#)

21 [Vendim-Nr. -407-dt.-17.12.2021-1.pdf \(klp.al\)](#)

22 [Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë" – Këshilli i Lartë i Prokurorisë \(klp.al\)](#)

23 [Akte nënligjore të Klp – Këshilli i Lartë i Prokurorisë](#)

dhe Matrica e Vlerësimit të Riskut, e cila është pjesë përbërëse e planit strategjik dhe përshkruan risqet, probabilitetin dhe ndikimin e mundshëm të këtyre risqeve në performancën institucionale. Gjithashtu, kjo matricë përfshin dhe masat lehtësuese për shmangien apo minimizimin e efektit dhe pasojave negative që sjellin risqet e identifikuar.

Lidhur me raportimin e planit strategjik dhe planit të veprimit parashikohet përgatitja e një raport progresi tremujor pas përfundimit të periudhës tremujore, ndërsa raporti i dytë tremujor do të përfshijë edhe një raport më të gjerë gjashtëmujor duke trajtuar ndjekjen e treguesve të performancës dhe planin më të gjerë të strategjisë. Pra, çdo tre muaj do të përgatitet një raport për periudhën kohore 3, 6, 9 dhe 12 muaj, duke ndjekur në këtë mënyrë treguesit numerikë dhe objektivat më të gjera të planit 4-vjeçar. Bazuar në nenin 40, germa a)²⁴ të rregullores së brendshme të miratuar me Vendimin Nr. 407, datë 17.12.2021²⁵, hartimi dhe monitorimi i zbatimit të Planit Strategjik është detyrë funksionale e Komisionit të Planifikimit, Administrimit dhe Buxhetit, i cili njëkohësisht raporton para Këshillit lidhur me zbatimin e tij. Ky komision ka hartuar dhe miratuar një raport të hollësishëm lidhur me zbatimin e Planit Strategjik 2021-2024. Në raportin vjetor të punës²⁶ së këtij komisioni janë trajtuar hollësisht përbushja e objektivave të këtij plani sipas treguesve përkatës. Ky detyrim është parashikuar edhe në Planin Strategjik, në kapitullin XI mbi Raportimin, Treguesit e Performancës dhe Sistemi i Menaxhimit të Performancës.²⁷

Neni 9, pika 1, germa a), e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, parashikon rolin e Sekretarit të Përgjithshëm, i cili siguron drejtimin strategjik për përgatitjen dhe përditësimin periodik të planit strategjik dhe buxhetit.

Pavarësisht se në Planin Strategjik nuk parashikohet bërja publike e këtyre raporteve periodike monitoruese, një informacion i përmbledhur mbi zbatimin e Planit Strategjik është paraqitur dhe në Raportin vjetor të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2023 (fq. 46-47)²⁸. Gjithsesi, në kuadër të transparencës dhe llogaridhënies institucionale këshillohet që në faqen zyrtare të KLP të realizohet publikimi i raporteve monitoruese të këtij dokumenti strategjik.

Pavarësisht se një institucion relativisht i ri, KLP ka vendosur Planin e Integritetit të Administratës së KLP 2023-2025 si një gur themeli në qasjen strategjike dhe në përforcimin e parimeve të integritetit dhe të etikës. Përgatitja e këtij dokumenti karakterizohet nga një frymë gjithëpërfshirëse, gjë që dëshmon për angazhim serioz të institucionit në përgatitjen e dokumenteve strategjike. Është ngritur një grup pune me përfaqësues të të gjitha departamenteve të administratës së KLP-së, i cili ka punuar intensivisht për jetësimin e Planit të Integritetit.

Plani i Integritetit në përgjithësi dhe Plani i Veprimit në veçanti bazohen në katër objektiva të qarta, të cilat janë në funksion të integritetit dhe transparencës institucionale. Më qëllim që të përmbushet çdo objektivi i përcaktuar, Plani i Veprimit identifikon risqet konkrete si dhe masat që duhen marrë me qëllim zbutjen apo minimizimin e këtyre risqeve. Në total, Plani i Veprimit ka identifikuar 36 risqe, nga të cilat 24 me ndikim “mesatar” dhe 12 me ndikim “të lartë”. Për çdo risk të identifikuar, Plani i Veprimit parashikon masa konkrete, një, dy ose më shumë masa të marra në funksion të minimizimit të riskut. Në total, Plani i Veprimit parashikon 79 masa për 36 risqet e identifikuar, konkretisht 29 masa për risqet me ndikim të lartë, dhe 50 masa për risqet me ndikim mesatar. Konstatohet që ka një lidhje të qartë dhe të drejtpërdrejtë të risqeve të identifikuar dhe masave të parashikuara, në funksion të plotë dhe proporcional me përmbushjen e objektivave të parashikuara, duke synuar integritetin institucional të KLP.

24 Për hartimin dhe monitorimin e zbatimit të Planit Strategjik, në përputhje me objektivat e Ligjit “Për qeverisjen dhe koordinimin me strategjinë e sektorit të drejtësisë”.

25 <https://klp.al/2021/12/22/per-organizimin-dhe-funksionimin-e-brendshem-te-keshillit-te-larte-te-prokurorisë/>

26 <https://klp.al/wp-content/uploads/2024/06/Raporti-i-Komisionit-te-Planifikimit-dhe-Buxhetit-2023.pdf>

27 Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit pranë KLP-së do të realizojë planifikimin dhe monitorimin nën mbikëqyrjen e vet Këshillit.

28 <https://klp.al/wp-content/uploads/2024/05/Raporti-Vjetor-2023.pdf>

Monitorimi i zbatimit të Planit të Integritetit është periodik (1-vjeçar), ndërsa raportimi bëhet mbi zbatimin e masave të parashikuara në të çdo gjashtë muaj dhe ndiqet nga një person përgjegjës i caktuar me urdhër të titullarit. Në pikën 2²⁹, të vendimit Nr. 52, datë 02.03.2023, të Kryetarit të KLP-së, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm me zbatimin e Planit të Integritetit, në përputhje me sa parashikohet në nenin 9, pika 3³⁰, germa “o”, e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, miratuar me Vendimin Nr. 405, datë 28.12.2023.

Me Urdhrin Nr. 111, datë 03.07.2024, “Për caktimin e koordinatorit përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të Urdhrit Nr. 52, datë 02.03.2023, “Për miratimin e planit të integritetit të administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë 2023-2025”, të Sekretarit të Përgjithshëm, për monitorimin e zbatimit dhe raportimit të Planit të Integritetit është ngarkuar drejtuesja e Njesisë së Shërbimeve Ligjore pranë Këshillit. Në funksion të efikasitetit të procesit të raportimit dhe monitorimit, sugjerohet që këto procese pune të jenë pjesë përbërëse e përshkrimit të punës, pasi në këtë mënyrë sigurohet qëndrueshmëria e monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit në vijimësi.

Plani i Integritetit është miratuar me datë 02.03.2023, por ende nuk është përgatitur raporti i parë i monitorimit të zbatimit. Kjo lidhet me caktimin e koordinatorit përgjegjës, që u realizua në korrik të këtij viti. Ndërkohë ka nisur puna për përgatitjen e raportit të parë të monitorimit. Në kuadër të transparencës dhe llogaridhënies institucionale, sugjerohet që ky raport monitorimi të bëhet publik në faqen e internetit të institucionit.

3. REKOMANDIME PËR QASJEN STRATEGJIKE

Të realizohet në mënyrë periodike raportimi dhe monitorimi i dokumenteve strategjike institucionale.

Të përcaktohen qartë funksionet dhe/ose strukturat përgjegjëse për zbatimin dhe raportimin e monitorimit të dokumenteve strategjike.

Të përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e funksioneve dhe/ose strukturave përgjegjëse në përshkrimet e punës.

Të mundësohet trajnim i vazhdueshëm i personit dhe/ose strukturës përgjegjëse.

Të merren masa që personi dhe/ose struktura përgjegjëse të ketë vijimësi afatgjatë në ato pozicione, pasi në këtë mënyrë sigurohet qëndrueshmëria e zbatimit dhe monitorimit të dokumenteve strategjike.

Të realizohet publikimi periodik i raporteve të monitorimit në faqen zyrtare të institucionit.

Të merren masa për përditësimin e Planit të Strategjik, pas përgatitjes së një vlerësimi të brendshëm dhe të jashtëm mbi realizimin e objektivave dhe treguesve ekzistues.

Të merren masa që institucioni të caktojë burime (njerëzore, financiare dhe administrative) të mjaftueshme me qëllim zbatimin e dokumenteve strategjike.

29 Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e Planit të Integritetit.

30 Sekretari i Përgjithshëm ushtron çdo detyrë të autorizuar nga Kryetari i Këshillit.

IV. STANDARDET ETIKE

Kontrolli ligjor dhe institucional	Objektivi i vlerësimit / Mënyra e Verifikimit	Pikët maksimale	Vlerësimi	Rekomandime Metodologjike
Standardet etike/të integritetit	Institucioni ka një Kod Etike/Sjelljeje apo një seksion përkatës në një akt tjetër të brendshëm.	2	2	KLP nuk ka një Kod Etike të mirëfilltë, por përgjegjësia disiplinore e lidhur me sjelljen etike të anëtarëve të Këshillit dhe të punonjësve të administratës të KLP-së përcaktohen kryesisht në Ligjin Nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar. Për nëpunësit e administratës së KLP-së përgjegjësia disiplinore e lidhur me sjelljen etike parashikohet edhe në Ligjin Nr. 9131/2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike", si dhe në rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e administratës së KLP-së. Në Planin e Integritetit të administratës së KLP-së parashikohet ngritja e një grupi pune për përgatitjen e Kodit të Etikës.
	Institucioni ka zhvilluar seanca informative/ trajnime për kuadrin rregullator për etikën dhe integritetin me punonjësit e institucionit (administratë dhe staf politik)	1	0.5	KLP nuk ka zhvilluar seanca informuese dhe/ose trajnime për kuadrin rregullator për etikën dhe integritetin, por nëpunësit civilë kanë marrë pjesë në aktivitete të ngjashme trajnuese të zhvilluara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), ku janë trajtuar tema që lidhen me etikën dhe integritetin.
	Plani vjetor i trajnimeve të institucionit përmban trajnime për etikën dhe integritetin.	1	1	KLP konfirmon të ketë një plan trajnimesh, ku identifikon dhe nevojat për trajnim për vitin 2024, i cili zbatohet në bashkëpunim me ASPA. Në kërkesat për trajnim që i drejtohet ASPA-s janë të përfshirë dhe trajnime me temë Etika dhe Integriteti. Për vitin 2024 është mbajtur një trajnim i tillë në muajin prill ku morën pjesë 7 nëpunës civilë që punojnë në sektorë të ndryshëm, të tillë si: Burimet Njerëzore, Financa, Prokurimet dhe Dokumentimi i Seancave.

Kontrolli ligjor dhe institucional	Objektivi i vlerësimit / Mënyra e Verifikimit	Pikët maksimale	Vlerësimi	Rekomandime Metodologjike
Rregullat dhe procedurat për sjelljen jo-etike dhe mbrojtjen e sinjalizuesve	Institucioni ka krijuar një njësi përgjegjëse dhe funksionale që regjistron, heton dhe shqyrton në mënyrë administrative raportet për veprimet ose praktikatat e dyshuara korruptive;	1	0	KLP konfirmon që nuk ka krijuar një strukturë të tillë, por në çdo rast, nëse shfaqen situata, veprime apo praktika të dyshuara korruptive, ndiqen procedurat ligjore sipas Kodit të Procedurës Penale.
	Institucioni ka hartuar një rregullore të brendshme të miratuar që përcakton procedurat për hetimin administrativ të rasteve të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit	1	1	Ligji Nr. 60/2016, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", nuk është i aplikueshëm për KLP, pasi bazuar në nenin 10, pika 1, njësi përgjegjëse caktohet pranë çdo autoriteti publik i cili ka më shumë se 80 të punësuar. Numri i punonjësve të KLP është 75 (https://klp.al/stafi-yne/).
	Rregullat dhe procedurat për njoftimin, shqyrtimin, zbulimin dhe raportimin e mangësive, mospërputhjeve dhe shkeljeve jo-etike.	1	0	KLP konfirmon që deri më tani nuk ka pasur ndonjë rast të shkeljeve etike nga nëpunësit civilë të administratës të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Nëse do të ketë raste të tilla, do të aplikohen rregullat dhe procedurat e parashikuara në Ligjin Nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar; Ligjin Nr. 9131/2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike", si dhe në rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e administratës së KLP-së.

Kontrolli ligjor dhe institucional	Objektivi i vlerësimit / Mënyra e Verifikimit	Pikët maksimale	Vlerësimi	Rekomandime Metodologjike
Rregullat për konfliktin e interesit	Institucioni ka ngritur autoritetin përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesit dhe ka miratuar rregulloren përkatëse.	2	0	KLP konfirmon që përmes Urdhrit Nr. 218, datë 24.10.2023, ka ngritur strukturën e autoritetit përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave. Kjo strukturë përbehet nga 3 persona që ndihmojnë punonjësit që janë subjekt i deklaramit të pasurisë dhe konfliktit të interesave. Për vitin 2023 numri i zyrtarëve që mbartin detyrim për deklarim ka qenë 37. Këshilli nuk ka miratuar ende rregulloren "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", pasi ka qenë e kushtëzuar nga miratimi i rregullores për organizimin dhe funksionimin e administratës së KLP. Raport Vjetor ILDKPKI 2023.pdf
	Institucioni raporton rregullisht për ILDKPKI me regjistrin e konfliktit të interesit.	1	1	KLP ka paraqitur raportin vjetor për periudhën janar-dhjetor 2023 të depozituar pranë ILDKPKI ku raporton për ecurinë dhe problematikën e ndeshur gjatë vitit raportues. Pjesë e raportimit është dhe lista e plotë e zyrtarëve të cilët janë subjekt deklarimi, bazuar në regjistrin themeltar të zyrtarëve që mbartin detyrim për deklarim të interesave private. (Raport Vjetor ILDKPKI 2023.pdf)
Kontrolli ligjor dhe institucional		10	5.5	

Kontrolli i zbatimit në praktikë	Objektivi i vlerësimit / Mënyra e Verifikimit	Pikët maksimale	Vlerësimi	Rekomandime Metodologjike
	Numri i rasteve të raportuara apo trajtuara për konflikt interesi në një vit. (Referojuni njërit nga tre vitet e fundit nga periudha që po aplikoni vlerësimin).	2	0	Në raportin vjetor 2023 depozituar pranë ILDKPKI-së, KLP raporton se nuk ka pasur asnjë rast për sa i përket identifikimit dhe regjistrimit të rasteve të konfliktit të interesave. (Raport Vjetor ILDKPKI 2023.pdf)
	Numri i rasteve të raportuara si raste të marrjes së ryshfetit, veprime korruptive dhe abuzim me detyrat (në një vit, referojuni një nga tre vitet e fundit nga koha që po aplikoni vlerësimin).	2	0	KLP konfirmon që nuk ka pasur raste të marrjes së ryshfetit veprimeve korruptive, apo abuzimit me detyrat.
	Numri i raste të regjistruara si dhurata apo mikpritje ((në një vit, referojuni njërit nga tre vitet e fundit nga viti që po aplikoni vlerësimin).	2	0	KLP konfirmon vetëm një rast si dhuratë institucionale. Gjatë vitit 2019, OPDAT ka dhuruar disa pajisje (kompjuter dhe printer) për nevoja të institucionit, në periudhën e parë të funksionimit pas krijimit të institucionit. Nuk janë raportuar raste të nga institucioni lidhur dhurata individuale për shkak të funksionit.

Kontrolli i zbatimit në praktikë	Objektivi i vlerësimit / Mënyra e Verifikimit	Pikët maksimale	Vlerësimi	Rekomandime Metodologjike
Niveli i ekzistencës dhe zbatimit të standardeve të integritetit	Akte të brendshme që dëshmojnë se ndërmerren veprime sipas Kodit të Etikës/të Sjelljes ose udhëzimeve për standardet e integritetit të institucionit.	2	0	Rregullat e sjelljes të nëpunësve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë përcaktohen në ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse, konkretisht, Ligji Nr. 115/2026, Ligji Nr. 9131/2003, si dhe rregullorja e brendshme për organizimin dhe funksionimin e administratës së KLP-së. Institucioni konfirmon që deri tani nuk ka pasur raste të shkeljeve etike nga nëpunësit civilë të administratës së KLP-së.
	Vlerësim të rasteve të sinjalizuara të hetuara administrativisht nga njësi përgjegjëse (sipas nenit 13/1 të Ligjit Nr. 60/2016).	2	2	Ligji Nr. 60/2016, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve" nuk është i aplikueshëm për KLP-në, pasi bazuar në nenin 10, pika 1, njësi përgjegjëse caktohet pranë çdo autoriteti publik i cili ka më shumë se 80 të punësuar. Numri i punonjësve të KLP është 75. (https://klp.al/stafi-yne/)
Kontrolli i zbatimit në praktikë		10	2	
Pikët për standardet e integritetit		20	7.5	

1. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Nëpunësit e administratës të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si përfaqësues të administratës publike, duhet të zbatojnë standardet më të larta të sjelljes etike, në përputhje me vlerat e integritetit, paanshmërisë dhe maturisë profesionale, të cilat janë parime themelore për të siguruar një funksionim të përshtatshëm të institucioneve publike. Formalizimi i këtyre parimeve e standardeve ndihmon punonjësit që të shmangin çdo sjellje të pahijshme apo komprometuese gjatë ushtrimit të detyrës së tyre.

Për këtë qëllim, institucionet publike, përfshirë dhe KLP-në, integritetin dhe etikën profesionale e integrojnë në dispozitat ligjore, rregullore dhe/ose akte nënligjore të brendshme. Konkretisht, përgjegjësia disiplinore e lidhur me sjelljen etike të anëtarëve dhe punonjësve të administratës së KLP trajtohet në Ligjin Nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Ndërsa për administratën e KLP-së, krahas ligjit të lartpërmendur, zbatohet edhe Ligji Nr. 9131/2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, si dhe rregullat e parashikuara në Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, miratuar me Vendimin Nr. 405, datë 28.12.2023, të Këshillit³¹.

Pavarësisht faktit që KLP nuk zhvillon seanca informuese ose trajnime për kuadrin rregullator për etikën dhe integritetin, institucioni bashkëpunon me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), ku përmes planit vjetor të trajnimeve i trajton kërkesat për trajnim të nëpunësve të KLP-së për tema që lidhen me etikën dhe integritetin. Nisur nga rëndësia e këtyre trajnimeve, rekomandohet bashkëpunimi i mëtejshëm me ASPA-n në mënyrë që tema të tilla të jenë pjesë e planit vjetor të trajnimeve për punonjësit e administratës të KLP-së. Përveç kësaj, rekomandohet që edhe vetë institucioni duhet të angazhohet në promovimin e çështjeve të etikës dhe integritetit, përmes fushatave ndërgjegjësuese, apo publikimit të broshurave dhe materialeve të tjera informative dhe ndërgjegjësuese.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë është funksional që në vitin 2019, por masat e marra në kuadër të zbatimit të Ligjit Nr. 9367/2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, datojnë në vitin 2023. Përmes Urdhrit Nr. 218, datë 24.10.2023, “Për ngritjen e Autoritetit Përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave”, është ngritur kjo strukturë e posaçme e institucionit, e përbërë nga tre punonjës, e cila synon identifikimin, regjistrimin, trajtimin dhe parandalimin e konfliktit të interesave.

Ligji Nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, nuk është i aplikueshëm për KLP-në, pasi bazuar në nenin 10, pika 1, njësia përgjegjëse caktohet pranë çdo autoriteti publik i cili ka më shumë se 80 të punësuar. Numri i punonjësve të KLP-së është 75³².

2. KONTROLI I ZBATIMIT NË PRAKTIKË

Përgjegjësia disiplinore e lidhur me sjelljen etike të anëtarëve të Këshillit trajtohet në nenet 103-103/3, të Ligjit Nr. 115/2026, i ndryshuar “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Sjellja joetike gjatë ushtrimit të funksionit ose jashtë tij që diskrediton pozitën dhe figurën e anëtarit të Këshillit ose dëmton besimin e publikut tek prokuroria përbën shkelje disiplinore. Neni 104, paragrafi 1, i këtij ligji, parashikon hollësisht procedurën disiplinore në ngarkim të çdo anëtarit të Këshillit. Duke qenë se, ex lege anëtarët e Këshillit gëzojnë statusin e magjistratit, ndaj tyre veprojnë rregullat e etikës të miratuara me Vendimin Nr. 32, datë 24.02.2022, “Për miratimin e standardeve të etikës dhe rregullave të sjelljes të prokurorit”, të Këshillit.³³ Ndërsa, sa i takon punonjësve të administratës së Këshillit, referuar nenit 176, të të njëjtit ligj, ata gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe ndaj tyre zbatohet legjislacioni për nëpunësit civil, veç rasteve kur ky ligj parashikon ndryshe. Përveç zbatimit të Ligjit Nr. 9131/2003, “Për rregullat e etikës

31 <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/12/28/405/6d028c8c-8e41-473c-a22a-e2224f760b34;q=rregullore%20per%20funksionimin%20e%20administrates%20keshilli%20i%20larte%20i%20prokurorise>

32 STAFI YNE – KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË (klp.al)

33 <https://klp.al/2022/03/03/standardet-etikes-dhe-rregullat-e-sjelljes-se-prokurorit/>

në administratën publike”, ndaj nëpunësve civilë të Këshillit zbatohen edhe rregullat e parashikuara në Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, miratuar me Vendimin Nr. 405, datë 28.12.2023, të Këshillit³⁴ (neni 28 dhe vijues).

Sipas Planit të Integritetit të administratës së KLP, rezulton që institucioni nuk ka Kod Etike. Në gjashtë mujorin e parë të 2023 është parashikuar të ngrihet grupi i punës për përgatitjen e Kodit të Etikës. Gjatë përgatitjes së këtij dokumenti, KLP duhet të marrë parasysh edhe dispozitat e Ligjit Nr. 9131/2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, që përcakton rregullat e sjelljes të nëpunësve të administratës publike

Pavarësisht mungesës së këtij dokumenti, aspekti i përgjithshëm i etikës dhe integritetit është pjesë përbërëse e legjislacionit mbi të cilin KLP ushtron funksionin e tij, si dhe trajtohet edhe në aktet nënligjore të brendshme, siç është rregullorja për organizimin dhe funksionimin e administratës së KLP. Gjithsesi, përgatitja e një Kodi të Etikës është e këshillueshme, pasi hartimi i këtij dokumenti sipas pikave të parashikuara në Planin e Integritetit³⁵, trajton çështje të etikës dhe integritetit në një plan shumë dimensional dhe gjithëpërfshirës, duke trajtuar aspekte që aktualisht nuk parashikohen në legjislacionin dhe aktet nënligjore të lartpërmendura.

Në mbështetje të nenit 41, pika 2, germa b)³⁶ dhe të nenit 42, pika 3, të Ligjit Nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, KLP ka ngritur strukturën e posaçme të autoritetit përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave në Këshillin e Lartë të Prokurorisë³⁷. Kjo strukturë përbëhet nga 3 persona që ndihmojnë punonjësit që janë subjekt i deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesave. Për vitin 2023, numri i zyrtarëve që mbartin detyrim për deklarim ka qenë 37 punonjës. Gjatë vitit raportues, KLP nuk ka identifikuar dhe regjistruar raste të konfliktit të interesave. Gjithashtu, Këshilli nuk ka miratuar ende rregulloren “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, pasi ka qenë e kushtëzuar nga miratimi i rregullores për organizimin dhe funksionimin e administratës së KLP-së.

Lidhur me strukturën e Autoritetit Përgjegjës, duhen theksuar dy aspekte:

- a. hartimi i dokumentacionit përkatës të Autoritetit Përgjegjës, siç është regjistri themeltar i subjekteve që mbartin detyrim për deklarim, por dhe mbajtja e një regjistri të posaçem për regjistrimin rast pas rasti të konfliktit të interesave, parashikuar në nenin 11 të Ligjit Nr. 9367/2005, i ndryshuar “Regjistrimi rast për rast i konfliktit të interesave³⁸;
- b. në përshkrimin e pozicionit të punës, për detyrën e autoritetit përgjegjës të vendosen kritere dhe për njohjen e ligjeve për deklarimin e pasurive dhe parandalimin e konfliktit të interesave, parashikuar në nenin 42, pika 3 të ligjit për konfliktin e interesave. Është shumë e rëndësishme

34 <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/12/28/405/6d028c8c-8e41-473c-a22a-e2224f760b34;q=rregullore%20per%20funksionimin%20e%20administrates%20keshilli%20i%20larte%20i%20prokurorise>

35 Kodi i Etikës duhet të përfshijë:

- parimet etike dhe standardet e sjelljes të punonjësve të KLP-së si pjesë e administratës publike;
- rregulla të qarta për procesin e deklarimit dhe pranimit të dhuratave dhe përfitime të tjera të ngjashme;
- detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit dhe rregulla për mbrojtjen e të dhënave personale;
- rregulla të qarta për veprimtarinë e jashtme të punonjësve të institucionit, deklarimin e tyre me formatet përkatëse;
- rregulla për komunikimin brenda administratës dhe me të tretë;
- rregulla për përdorimin e mediave sociale të punonjësve;
- rregulla për përdorimin të pasurisë dhe burimeve materiale të KLP për nevoja vetjake;
- përdorimi i kohës së punës dhe paraqitja në punë e punonjësve të administratës.
- Subjektet e zbatimit të Kodit të Etikës të jenë edhe kabineti i kryetarit të KLP-së. Informimi/kryerja e trajnimeve të brendshme të punonjësve të KLP-se për këtë Kod.

36 Drejtoritë, njësitë e burimeve njerëzore apo njësi të ngarkuara a të ngritura posaçërisht, sipas nevojës dhe mundësive të çdo institucioni publik

37 Raport Vjetor ILDKPKI 2023

38 Për çdo rast të shfaqjes së një konflikti rast për rast të interesit, regjistrohen identiteti i zyrtarit, interesat private të tij, shkak për një konflikt interesi, thelbi i konfliktit, palët e interesuara, burimi i të dhënave, mënyra e marrjes dhe e verifikimit të tyre, si dhe vendimi që është marrë, mbështetur në këto të dhëna, përfshirë edhe vendimet e marra nga eprorët, institucionet eprorë ose nga gjykatat.

që detyrat dhe përgjegjësitë që do të kryhen nga Autoriteti Përgjegjës të jenë të parashikuara në përshkrimet e tyre të punës.

Lidhur me dhuratat institucionale, institucioni raporton vetëm një rast të tillë, pajisje kompjuterike, për nevoja të institucionit pas krijimit të tij, por nuk ka raste të raportimeve për dhurata personale të punonjësve për shkak të funksionit. Duke pasur parasysh që KLP është një institucion relativisht i ri, që mbështetet nga donatorë të ndryshëm, institucioni duhet të krijojë një praktikë punë mbi donacionet apo rastet e sponsorizimeve, në rast se institucioni do të ketë një numër të konsiderueshëm donacionesh apo dhuratash institucionale në të ardhmen. Është e rëndësishme që institucionet të kenë rregulla të qarta për donacionet, dhuratat institucionale, apo sponsorizimet, me qëllim që ato të jenë në funksion të plotë dhe të drejtpërdrejtë të misionit dhe objektivave të institucionit.

Nga analiza e informacionit të vënë në dispozicion nga KLP, si dhe të mbledhur nga ekspertët, lidhur me pjesën e kontrollit dhe të zbatimit në praktikë, konstatohet mungesa e statistikave për trajtimin e rasteve dhe praktikave institucionale në përditshmërinë e Këshillit. Nga njëra anë, kjo mund të rezultojë si diçka pozitive, pasi nënkupton që institucioni nuk ka raste të konfliktit të interesit, nuk ka shkelje të rregullave të etikës, nuk ka raste të raportuara për abuzim me detyrën, apo marrje ryshfeti, etj., dhe kjo është rezultat i një etiketë lartë të institucionit ose mund të justifikohet me faktin që KLP është institucion i ri, dhe kjo mund të jetë dhe arsyeja pse nuk ka statistika për raste apo praktika konkrete. Gjithashtu, institucioni raporton që nuk ka një njësi përgjegjëse dhe funksionale që regjistron, heton dhe shqyrton në mënyrë administrative raportet për veprimet ose praktikat e dyshuara korruptive, por nëse do të shfaqen situata, veprime apo praktika të dyshuara korruptive, do të ndiqen procedurat ligjore sipas Kodit të Procedurës Penale.

3. REKOMANDIME PËR STANDARDET ETIKE

- » Hartimi dhe përgatitja e Kodit të Etikës, sipas planifikimit të Planit të Integritetit të administratës së KLP, duke përfshirë të gjitha pikat e parashikuara në këtë dokument (Plani i Integritetit) dhe në përputhje me aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi
- » Hartimi i rregullores së konfliktit të interesave në bashkëpunim me ILDKPKI, si autoriteti qendror përgjegjës për zbatimin e Ligjit Nr. 9367/2005, të ndryshuar.
- » Marrja e masave nga ana e autoritetit përgjegjës të KLP-së për hartimin e dokumentacionit shoqëruar të kësaj strukture, siç është regjistri i identifikimit, trajtimit dhe parandalimit të konfliktit të interesave.
- » Parashikimi i detyrave dhe përgjegjësiave të autoritetit përgjegjës të Këshillit në përshkrimin e punës të punonjësve të caktuar pranë kësaj strukture.
- » Trajnimi periodik i punonjësve të autoritetit përgjegjës mbi identifikimin, parandalimin, trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesave, si dhe mbi mbajtjen e dokumentacionit përkatës të kësaj strukture.
- » Të thellohet bashkëpunimi me ASPA, me aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile, si dhe me donatorë të ndryshëm, lidhur më ofrimin e trajnimeve periodike për etikën dhe integritetin për stafin e KLP-së.
- » Hartimi i një rregullore ose zhvillimi i një praktike pune për dhuratat institucionale, donacionet apo sponsorizimet që i ofrohen institucionit apo punonjësve të institucionit për shkak të detyrës³⁹ nga donatorë të ndryshëm ose entitete private.

39 Ky rekomandim vlen vetëm në rast se KLP në të ardhmen do të ketë një numër të konsiderueshëm dhuratash institucionale ose raste të dhuratave, donacioneve apo sponsorizimeve ndaj punonjësve të institucionit për shkak të detyrës

V. MERITOKRACIA

Kontrolli ligjor dhe institucional	Objekti/Mënyra e Verifikimit	Pikët maksimale	Vlerësimi	Rekomandime Metodologjike
Rekrutimi sipas meritës	Vendet e lira të punës në institucion shpallen publikisht. Meritokracia reflektohet në shpalljen e kërkesave për t'u përmbushur nga kandidatët.	2	2	<p>Administrata e KLP-së bën pjesë në shërbimin civil, e për pasojë, lidhur me rekrutimet i nënshtrohet legjislacionit për nëpunësin civil. Konkretisht, ajo bazohet në ligjin Nr. 152/2016, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, VKM Nr. 243, datë 18.03.2015, "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", të ndryshuar, VKM Nr. 242, datë 18.03.2015, "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e nivelit të ulët dhe të mesme drejtuese", të ndryshuar, VKM Nr. 118, datë 5.3.2014 "Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së", të ndryshuar, si dhe VKM Nr. 108, datë 26.2.2014, "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil", të ndryshuar.</p> <p>Sipas konfirmimit të njësisë së Burimeve Njerëzore të institucionit konfirmohet se , për vitin 2023, janë shpallur 17 vende, nga të cilat janë punësuar 15 nëpunës civilë dhe 2 vende janë shpallur, por nuk janë plotësuar. Raport i i kërkuar për matjen e këtij treguesi rezulton të jetë 1 (17-2/15= 1)</p>
	Ka mungesë të punësimit me transparencë; ekzistojnë raste të bëra publike në media.	2	2	Nuk rezulton të ketë raportime në media për raste punësimi jo meritokratik në administratën e KLP-së.

Kontrolli ligjor dhe institucional	Objekti/Mënyra e Verifikimit	Pikët maksimale	Vlerësimi	Rekomandime Metodologjike
Vlerësimi i / analiza e performancës së stafit	Institucioni ka një praktikë të vlerësimit të performancës së punonjësve.	2	1	Këshilli i Lartë i Prokurorisë realizon vlerësimin për punonjësit e administratës, bazuar në legjislacionin për nëpunësin civil dhe konkretisht duke u bazuar në VKM Nr. 109, datë 26.2.2014, "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë". Institucioni konfirmon ndjekjen e hapave dhe procedurave sipas këtij legjislacioni. KLP nuk ka rregulla udhëzuese për realizimin e këtij procesi në aktet e tij të brendshme. Bashkëlidhur këtij dokumenti gjendet një praktikë që realizohet në mënyrë anonime.
	Raporti vjetor i performancës së punonjësve është hartuar, nga i cili formulohen udhëzime për menaxhimin e burimeve njerëzore.	2	0	Deri në momentin e këtij monitorimi, nuk përgatiten raporte performance të punonjësve në Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Në Planin e Integritetit të institucionit është parashikuar hartimi i një raporti për performancën e institucionit, që do të realizohej brenda vitit 2023, por një i tillë ende nuk ekziston dhe mbetet në proces, për t'u plotësuar në vijim.
Trajnimi dhe edukimi	Plani vjetor i trajnimeve i institucionit.	2	2	Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka një plan trajnimesh vjetor i cili përpilohet nga Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve duke pasur në konsideratë nevojat e evidentuara nga njësia dhe nga kërkesat e nëpunësve për trajnim dhe zbatohet në bashkëpunim me ASPA-n.
Kontrolli ligjor dhe institucional		10	7	

Niveli i zbatimit të standardeve të meritokracisë	Objekti/Mënyra e Verifikimit	Pikët maksimale	Vlerësimi	Rekomandime Metodologjike
	Numri i punonjësve të larguar nga puna kundrejt totalit të numrit të të punësuarve (në %).	2	2	Rezulton që numri i të larguarve nga institucioni në raport me totalin e të punësuarve në institucion është i vogël. Për vitin 2023 janë larguar 4 persona, kundrejt 67 të punësuarve në total në fund të vitit 2023. Pra, numri i të larguarve për vitin 2023 përbën rreth 6% të numrit total të personave të punësuar.
	Drejtorët e drejtorive kryejnë funksionet e tyre ligjore në procedurat e emërimit/ shkarkimit të stafit	2	2	<p>Nga institucioni konfirmohet që drejtuesit e drejtorive ushtrojnë të drejtat e tyre të njohura nga legjislacioni për nëpunësin civil, lidhur me procesin e rekrutimit dhe lirimit nga shërbimi civil. Konkretisht zbatohen:</p> <p>Ligji Nr. 152/2016, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.</p> <p>VKM Nr. 243, datë 18.03.2015, "Për pranim, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", të ndryshuar.</p> <p>VKM Nr. 242, datë 18.03.2015, "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e nivelit të ulët dhe të mesme drejtuese", të ndryshuar.</p> <p>VKM Nr. 118, datë 05.03.2014, "Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së", të ndryshuar;</p> <p>VKM Nr. 108, datë 26.2.2014, "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil", të ndryshuar.</p> <p>VKM Nr. 115 datë 05.03.2014, "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil".</p> <p>Megjithatë, kompetencat konkrete lidhur me procedurat e emërimit/ shkarkimit të stafit nuk përmenden në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Administratës së KLP.</p>

Niveli i zbatimit të standardeve të meritokracisë	Objekti/Mënyra e Verifikimit	Pikët maksimale	Vlerësimi	Rekomandime Metodologjike
	A sigurojnë rregulloret e brendshme/Kodi Etik aktivitetin politik të punonjësve ekzistues të sektorit publik (p.sh. anëtarësimi në parti, shprehja e pikëpamjeve politike)?	2	0	Referuar nenit 176 të Ligjit për qeverisjen, nëpunësit e administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe ndaj tyre zbatohet legjislacioni në fuqi për nëpunësit civilë, veç rasteve kur ky ligj parashikon ndryshe. Të drejtat politike të nëpunësve civilë përcaktohen në nenin 37, të Ligjit Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse. Ndërkohë, në rregulloren e brendshme të institucionit, nuk ka parashikime lidhur me aktivitetin politik. Gjithashtu, Kodi Etik i institucionit nuk është miratuar ende. Në praktikën e deritanishme Këshilli i Lartë i Prokurorisë, konfirmon se nuk ka pasur asnjë rast të aktivitetit të papërshtatshëm politik apo të vërejtjeve të dhëna për këtë shkak ndaj nëpunësve civilë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
	A kanë drejtuesit hapësira për t'u dhënë punonjësve stimuj që të kryejnë punën me transparencë, përgjegjshmëri dhe gjithë përfshirje, p.sh. nëpërmjet çmimeve, stimujve financiarë etj.?	2	0	Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk aplikon mekanizma stimulues apo promovues për punonjësit që kryejnë punën me transparencë, apo përgjegjshmëri. Deri në momentin e këtij monitorimi, nuk janë aplikuar stimuj (çmime, stimuj financiarë, etj.) për këtë kategori punonjësish.
	Raste të ankesave/konflikteve në punë të adresuara në Komisionin e Shërbimit Civil.	2	2	Gjatë viteve 2021-2023, nga punonjësit e Këshillit të Lartë të Prokurorisë nuk ka pasur raste të ankesave/konflikteve të adresuara në KSHC.
Niveli i zbatimit të standardeve të meritokracisë		10	6	
Total		20	13	

1. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Krijimi i një administrate të qëndrueshme, të përbërë nga profesionistë, kërkon politika të menaxhimit të burimeve njerëzore që bazohen tek meritokracia. Për këtë arsye, është e rëndësishme që institucioni të zbatojë praktika të konsoliduara lidhur me procesin e rekrutimit, vlerësimit të performancës, avancimit në karrierë apo shkarkimit, duke u bazuar në legjislacionin përkatës dhe rregullat e tij të brendshme të funksionimit.

Administrata e Këshillit të Lartë të Prokurorisë bën pjesë në shërbimin civil, e për pasojë, lidhur me procesin e rekrutimeve, i nënshtrohet legjislacionit për nëpunësin civil⁴⁰. Konstatohet se Këshilli i Lartë i Prokurorisë ndjek në mënyrë të rregullt procedurat e rekrutimit, nëpërmjet shpalljes, zbatimit të fazave dhe afateve përkatëse, si dhe bërjes publike të rezultateve të secilës fazë. Rezulton që për çdo të punësuar është ndjekur procedura standarde e rekrutimit, sipas legjislacionit në fuqi, dhe çdo rekrutim gjen pasqyrim në faqen zyrtare të institucionit.

Sa i takon vlerësimit të performancës të punonjësve, Këshilli i Lartë i Prokurorisë zbaton gjithashtu legjislacionin për nëpunësin civil⁴¹ dhe ndjek procedurat standarde, sipas këtij legjislacioni. Megjithatë, për një zbatim efektiv të këtij legjislacioni, si dhe në mënyrë që procesi i vlerësimit të mos shndërrohet në një proces formal, por të reflektojë rëndësinë që mbart, është e rëndësishme që Këshilli të përshtatë formularët e vlerësimit me përshkrimin e punës së çdo punonjësi, si dhe të ketë rregulla të brendshme, udhëzime dhe trajnime të stafit përgjegjës dhe punonjësve për mënyrën e vlerësimit. Edhe pse në Planin e Integritetit institucional është parashikuar ndërmarrja e masave të kësaj natyre, ato nuk janë përmbushur dhe mbeten për t'u realizuar në vijimësi.

Që procesi i vlerësimit të punonjësve të ketë ndikimin e vet në drejtim të përmirësimit të performancës së institucionit, është e rëndësishme që rezultatet e vlerësimit të gjithë punonjësve të përpunohen dhe të hartohet një raport me të dhëna cilësore dhe sasiore në nivel institucioni. Këshilli nuk ka hartuar deri më tani një raport të tillë, megjithëse e parashikon si masë për t'u ndërmarrë, në kuadër të Planit të Integritetit, e cila vijon të mbetet në proces.

Me qëllim rritjen e nivelit të profesionalizmit, stafi i institucionit duhet të trajnohet rregullisht, në mënyrë që të zhvillohen më tej aftësitë sipas nevojave dhe përshkrimit të punës. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka një plan trajnimesh vjetor, i cili përpilohet bazuar në nevojat e evidentuara nga njësia e burimeve njerëzore dhe që zbatohet në bashkëpunim me ASPA-n. Ky plan trajnimesh nuk gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Këshillit.

2. KONTROLLI I ZBATIMIT NË PRAKTIKË

Që një administratë të garantojë qëndrueshmëri, është e rëndësishme që punonjësit e saj të mos lëvizin apo largohen në mënyrë arbitrare nga puna. Si pjesë e shërbimit civil Këshilli i Lartë i Prokurorisë, respekton garancitë që vijnë nga legjislacioni i zbatueshëm për nëpunësin civil. Kjo reflektohet edhe në numrin e ulët të stafit të larguar, përgjatë viteve të ekzistencës së këtij institucioni. Gjithashtu nuk rezulton të ketë raste të bëra publike nëpërmjet medias për largime arbitrare nga puna, apo ankesa për shkelje të legjislacionit, drejtuar në Komisionin e Shërbimit Civil.

40 Konkretisht, ajo bazohet në ligjin Nr. 152/2016, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, VKM Nr. 243, datë 18.03.2015, "Për pranim, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", të ndryshuar, VKM Nr. 242, datë 18.03.2015, "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e nivelit të ulët dhe të mesme drejtuese", të ndryshuar, VKM Nr. 118, datë 5.3.2014, "Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së", të ndryshuar, si dhe VKM Nr. 108, datë 26.2.2014, "Për planin vjetor të pranimin në shërbimin civil", të ndryshuar,

41 VKM Nr. 109, datë 26.2.2014, "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë"

Një rol të rëndësishëm në kuadër të emërimit dhe shkarkimit, luajnë drejtuesit e drejtorive përkatëse, të cilët duhet që të ushtrojnë kompetencat e njohura nga legjislacioni për nëpunësin civil⁴² në këto procese. Megjithëse, KLP konfirmon ushtrimin e këtyre kompetencave, sugjerohet që kompetencat konkrete lidhur me procedurat e emërimit/shkarkimit të stafit të përmenden shprehimisht në detyrat e drejtuesve, në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Administrata e çdo institucioni duhet të jetë e depolitizuar dhe e distancuar nga politika. Për këtë duhet që çdo institucion të ketë rregulla konkrete për raportin e punonjësve me politikën. Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk rezulton të ketë në rregulloren e brendshme të aplikueshme për punonjësit, apo kod etik ku parashikohen rregulla të hollësishme për anëtarësimin në parti politike, pjesëmarrjen në aktivitete partiake, apo shprehjen e bindjeve politike. Edhe në këtë rast zbatohen rregullat e përgjithshme të aplikueshme për nëpunësin civil.⁴³ Këshilli konfirmon se nuk ka pasur deri më sot ndonjë rast problematik të një natyre të tillë.

Për promovimin e vlerave dhe standardeve të larta të etikës, apo integritetit një mënyrë është nëpërmjet aplikimit të stimujve. Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk aplikon mekanizma stimulues apo promovues për punonjësit që kryejnë punën me standarde të larta të etikës, transparencë, apo përgjegjshmëri.

3. REKOMANDIME PËR MERITOKRACINË

Në kuadër të përmirësimit të standardeve të aplikueshme për meritokracinë, institucioni sugjerohet që:

- » Në Rregulloren e Brendshme dhe në përshkrimet e punës të drejtuesve të përmenden shprehimisht kompetencat përkatëse në procesin e emërimit apo shkarkimit të punonjësve.
- » Formularët e vlerësimit të performancës të mbajnë parasysh përshkrimet e punës si dhe të hartohen udhëzues përkatës për vlerësimin e performancës.
- » Vlerësimet e performancës të punonjësve të përpunohen dhe në bazë të tyre të hartohet raporti i performancës në nivel institucioni.
- » Në aktet e brendshme, apo në Kodin e Etikës që parashikohet të hartohet, të parashikohen rregulla të hollësishme për anëtarësimin në parti politike, pjesëmarrjen në aktivitete partiake, apo shprehjen e bindjeve politike.
- » Të krijohen mekanizma stimulues për promovimin e punonjësve që tregojnë një standard të lartë etik, përgjegjshmërie dhe integriteti.

42 Shih për më tepër Ligjin Nr. 152/2016 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, VKM Nr. 243, datë 18.03.2015, "Për pranim, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", të ndryshuar, VKM Nr. 242, datë 18.03.2015, "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e nivelit të ulët dhe të mesme drejtuese", të ndryshuar, VKM Nr. 118, datë 05.03.2014 "Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së, të ndryshuar, VKM Nr. 108, datë 26.2.2014 "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil", të ndryshuar, VKM Nr. 115 datë 05.03.2014, "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil".

43 Miratuar me vendimin Nr. 405, datë 28.12.2023 të Këshillit

